Monitorimi i Zbatimit të të Drejtave të Fëmijëve në Nivel Lokal



PRISHTINË, 2026

Ky raport është hartuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI), në kuadër të projektit "Avancimi i të Drejtave të Fëmijëve në Nivel Lokal", i cili zbatohet në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe mbështetet nga Qeveria Suedeze, përmes Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida).

Përgjegjësia për përmbajtjen e këtij raporti i takon autorit të tij. Pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në të nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë Suedeze apo të Save the Children

Raporti paraqet gjetjet e monitorimit të zbatimit të të drejtave të fëmijëve në nivel lokal dhe synon të shërbejë si pasqyrim i vlerësimin të angazhimit dhe performancës së institucioneve komunale në përmbushjen e detyrimeve të tyre ndaj fëmijëve.

Tabela përmbajtjes

4 **HYRJE**

6 **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

8 **QASJA NË ZBATIM (METODOLOGJIA)**

9 **DIMENSIONI 1**
MEKANIZMAT INSTITUCIONALË

13 **DIMENSIONI 2**
PLANIFIKIMI DHE POLITIKAT

18 **DIMENSIONI 3**
OFRIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE

22 **DIMENSIONI 4**
SHËRBIMET SPECIFIKE PËR FËMIJË

27 **DIMENSIONI 5**
FINANCIMI

31 **DIMENSIONI 6**
KONTRAKTIMI DHE LICENCIMI

38 **KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET**

HYRJE

Ky raport paraqet rezultatet e monitorimit të nivelit të zbatimit të të drejtave të fëmijëve në nivel lokal, me fokus në përmbushjen e përgjegjësive komunale në fushën e shërbimeve sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve gjatë vitit 2025.

Raporti është hartuar në kuadrin e projektit Avancimi i të Drejtave të Fëmijëve në Nivelin Lokal, nga Kosovo Local Government Institute (KLGI) në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financohet nga Swedish International Development Cooperation Agency (Sida), në kuadër të programit për fuqizimin e shoqërisë civile për të drejtat e fëmijëve

Gjatë periudhës qershor–shtator 2026, Instituti KLGI ka realizuar procesin e monitorimit të përmbushjes së obligimeve të komunave në fushën e shërbimeve sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve.

Monitorimi ka përfshirë të 38 komunat e Republikës së Kosovës dhe është organizuar në gjashtë fusha kryesore, me gjithsej 25 indikatorë, të cilët mbulojnë përgjegjësitë institucionale, planifikimin, ofrimin e shërbimeve dhe financimin e tyre.

Procesi i monitorimit është zhvilluar përmes një qasjeje të kombinuar të shqyrtimit të informatave publike dhe verifikimit të drejtpërdrejtë me komunat. Në fazën e parë janë shqyrtuar ueb-faqet zyrtare të komunave dhe dokumentet publike të disponueshme, me qëllim identifikimin e informatave dhe evidencës relevante për secilin indikator.

Pas përfundimit të monitorimit fillestar, të dhënat preliminare u janë dërguar komunave për shqyrtim, verifikim dhe plotësim. Për secilën përgjigje pozitive është kërkuar evidencë mbështetëse, me qëllim dallimin ndërmjet përmbushjes së dokumentuar dhe përmbushjes së deklaruar pa dokumentacion evidentues.

Nga 38 komunat e përfshira në proces, 28 komuna kanë kthyer përgjigje, ndërsa 10 komuna nuk kanë marrë pjesë në fazën e verifikimit. Për këtë arsye, analiza e detajuar e performancës, krahasimi ndërmjet komunave dhe renditja sipas indikatorëve janë zhvilluar mbi bazën e 28 komunave që kanë ofruar përgjigje dhe kanë mundësuar verifikimin e të dhënave.

Monitorimi është organizuar në gjashtë fusha kryesore:

- Mekanizmat institucionalë;
- Planifikimi dhe politikat;
- Ofrimi i shërbimeve sociale;
- Shërbimet specifike për fëmijë;
- Financimi;
- Kontraktimi dhe licencimi.

Këto fusha mbulojnë hallkat kryesore të sistemit komunal të mbrojtjes së fëmijëve dhe të shërbimeve sociale, duke filluar nga krijimi dhe funksionimi i mekanizmave institucionalë, planifikimi i politikave dhe ofrimi i shërbimeve, deri te sigurimi i financimit dhe bashkëpunimi me ofruesit e shërbimeve.

Qasja e përdorur në këtë raport synon të shkojë përtej konstatimit formal nëse një mekanizëm, plan, shërbim apo aktivitet ekziston. Një element qendror i monitorimit është niveli i verifikueshmërisë së përmbushjes. Për këtë arsye, të dhënat janë klasifikuar në tri kategori: të dhëna primare, kur përmbushja mbështetet me evidencë; të dhëna sekondare, kur përmbushja është deklaruar nga komuna pa evidencë; dhe pa përmbushje të verifikueshme, kur gjatë procesit nuk është siguruar bazë e mjaftueshme për të konstatuar përmbushjen.

Kjo qasje mundëson analizimin e performancës komunale në dy nivele të ndërlidhura: nivelin e përmbushjes së përgjegjësive dhe shkallën e dokumentimit të kësaj përmbushjeje.

Raporti ofron një pasqyrë krahasuese të gjendjes ndërmjet komunave dhe fushave të monitoruara, identifikon aspektet ku performanca është më e konsoliduar dhe evidenton boshllëqet që kërkojnë vëmendje dhe ndërhyrje të mëtejshme institucionale.

Përmes gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve, raporti synon të shërbejë si instrument orientues për komunat, institucionet e nivelit qendror, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët e fushës, në përcaktimin e prioriteteve dhe ndërmarrjen e masave për përmirësimin e shërbimeve sociale dhe avancimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në nivel lokal.

Në këtë kuptim, analiza nuk kufizohet vetëm në paraqitjen e rezultateve numerike, por synon të vlerësojë edhe ndërlidhjen ndërmjet mekanizmave institucionalë, planifikimit, ofrimit të shërbimeve, financimit dhe zbatimit praktik të përgjegjësive komunale, duke identifikuar hallkat ku paraqiten dobësitë kryesore dhe mundësitë për përmirësim.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Rezultatet tregojnë se performanca e komunave nuk është uniforme dhe se ekzistojnë dallime të konsiderueshme si ndërmjet dimensioneve, ashtu edhe ndërmjet nivelit të përmbushjes së evidentuar dhe nivelit të dokumentimit me evidencë primare.

Dimensioni 3, ofrimi i shërbimeve sociale paraqet nivelin më të lartë të përmbushjes së evidentuar, me 61.9% të rasteve. Megjithatë, struktura e evidencës është e ndarë në mënyrë të barabartë: 31.0% e rasteve mbështeten me evidencë primare dhe 31.0% me evidencë sekondare, ndërsa 38.1% rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e performancës së evidentuar në këtë dimension vazhdon të mbështetet në burime sekondare dhe jo në dokumentacion institucional të drejtpërdrejtë.

Dimensioni 1, mekanizmat institucionalë arrin 60.7% përmbushje të evidentuar. Në këtë dimension, 38.4% e rasteve janë të mbështetura me evidencë primare dhe 22.3% me evidencë sekondare, ndërsa 39.3% rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme. Krahasuar me Dimensionin 3, ky dimension ka nivel më të lartë të dokumentimit me evidencë primare, duke treguar se mekanizmat institucionalë janë relativisht më të formalizuar dhe më të dokumentuar.

Në Dimensionin 2, planifikimi dhe politikat, 57.1% e rasteve rezultojnë me përmbushje të evidentuar. Prej tyre, 36.6% mbështeten me evidencë primare dhe 20.5% me evidencë sekondare, ndërsa 42.9% mbeten pa përmbushje të verifikueshme. Kjo tregon një nivel mesatar të institucionalizimit të proceseve planifikuese, por edhe një varësi të konsiderueshme nga evidenca sekondare.

Dimensioni 6, kontraktimi dhe licencimi arrin 52.1% përmbushje të evidentuar, por struktura e evidencës paraqet një profil tjetër: vetëm 22.1% e rasteve janë të mbështetura me evidencë primare, ndërsa 30.0% me evidencë sekondare. Në këtë dimension evidenca sekondare është më e lartë se ajo primare, gjë që tregon se një pjesë e konsiderueshme e praktikave të kontraktimit, licencimit dhe monitorimit janë deklaruar ose konfirmuar pa dokumentacion primar të mjaftueshëm.

Dy dimensionet me nivelin më të ulët të performancës janë Financimi dhe Shërbimet specifike për fëmijë. Në Dimensionin 5, financimi, 21.4% e rasteve mbështeten me evidencë primare dhe 17.1% me evidencë sekondare, ndërsa 61.4% rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme. Në Dimensionin 4, shërbimet specifike për fëmijë, vetëm 14.3% e rasteve kanë evidencë primare dhe 15.2% evidencë sekondare, ndërsa 70.5% rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme.

Në Dimensionin 1, Ekipi për të Drejtat e Fëmijës paraqet indikatorin me performancën më të lartë. Nga 28 komuna, 17 komuna ose 60.7% kanë evidencë primare, ndërsa 6 komuna ose 21.4% kanë evidencë sekondare. Në total, 82.1% e komunave rezultojnë me përmbushje të evidentuar të këtij indikatori. Ky rezultat tregon se themelimi i Ekipit është një nga mekanizmat më të konsoliduar institucionalisht.

Megjithatë, funksionimi praktik i këtij mekanizmi është dukshëm më i dobët. Për takimet e Ekipit gjatë vitit 2025, 35.7% e komunave kanë evidencë primare dhe 17.9% evidencë sekondare, ndërsa 46.4% rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme. Në total, vetëm 53.6% e komunave rezultojnë se kanë zhvilluar takime. Kjo tregon një hendek të qartë ndërmjet themelimit formal të mekanizmit dhe funksionimit të tij të rregullt.

Indikatori më i dobët në Dimensionin 1 është zyrtari i specializuar për mbrojtjen e fëmijës në QPS. Vetëm 17.9% e komunave kanë evidencë primare, 25.0% kanë evidencë sekondare, ndërsa 57.1% rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme. Ky rezultat evidenton boshllëqe të rëndësishme në kapacitetet profesionale të specializuara dhe në dokumentimin e tyre.

Në Dimensionin 2, performanca më e lartë paraqitet te konsultimi me OJQ-të dhe aktorët lokalë. Për këtë indikator, 42.9% e komunave kanë evidencë primare dhe 28.6% evidencë sekondare, ndërsa 28.6% rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme. Në total, 71.4% e komunave kanë një formë të evidencës për përmbushjen e këtij indikatori.

Planifikimi social i bazuar në analiza të nevojave paraqitet me 32.1% evidencë primare dhe 17.9% sekondare, ndërsa programet komunale për mirëqenien e fëmijëve me 28.6% evidencë primare dhe 21.4% sekondare. Në të dy rastet, gjysma e komunave rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme.

Në Dimensionin 3, informimi i qytetarëve përmes QPS-së është indikatori me performancën më të lartë. 35.7% e komunave kanë evidencë primare dhe 32.1% evidencë sekondare, duke arritur 67.9% përmbushje të evidentuar. Lista publike e shërbimeve sociale ka 28.6% evidencë primare dhe 28.6% sekondare, ndërsa standardet minimale të shërbimeve sociale kanë 28.6% evidencë primare dhe 32.1% sekondare.

Dallimi më i madh shfaqet në Dimensionin 4, shërbimet specifike për fëmijë. Shërbimet në shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe sëmundje të rënda kronike paraqesin rezultatin më të mirë, me 25.0% evidencë primare dhe 32.1% evidencë sekondare, ose 57.1% përmbushje të evidentuar. Megjithatë, edhe në këtë indikator evidenca sekondare është më e lartë se ajo primare.

Qendrat e kujdesit ditor paraqesin rezultat dukshëm më të ulët: vetëm 10.7% e komunave kanë evidencë primare dhe 7.1% evidencë sekondare, ndërsa 82.1% rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme. Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve dhe shtëpitë me bazë në komunitet kanë secila 10.7% evidencë primare dhe 10.7% sekondare, duke arritur vetëm 21.4% përmbushje të evidentuar.

Dimensioni 5 e konfirmon këtë model edhe nga aspekti financiar. Mbështetja financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim paraqet performancën më të mirë të dimensionit, por vetëm 25.0% e komunave kanë evidencë primare, ndërsa 35.7% kanë evidencë sekondare. Kjo tregon se mbështetja financiare raportohet relativisht shpesh, por dokumentimi i saj primar mbetet më i kufizuar.

Financimi i qendrave të kujdesit ditor dhe i shtëpive me bazë në komunitet është dukshëm më i ulët. Në të dy indikatorët, vetëm 14.3% e komunave kanë evidencë primare dhe 7.1% evidencë sekondare, ndërsa 78.6% rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme.
Kjo lidhje ndërmjet Dimensionit 4 dhe Dimensionit 5 është veçanërisht e rëndësishme: shërbimet që janë më pak të disponueshme janë njëkohësisht edhe ato për të cilat evidentohet më pak financim.

Në Dimensionin 6, licencimi i ofruesve paraqet nivelin më të lartë të përmbushjes së evidentuar, me 75%. Megjithatë, vetëm 25.0% e komunave kanë evidencë primare, ndërsa 50.0% mbështeten në evidencë sekondare. Kjo tregon se niveli relativisht i lartë i përmbushjes së raportuar nuk shoqërohet me nivel të njëjtë të dokumentimit primar.

Kontraktimi i shërbimeve sociale paraqitet me 25.0% evidencë primare dhe 17.9% sekondare, ndërsa përputhshmëria e kontratave me planin vjetor me 28.6% evidencë primare dhe 14.3% sekondare. Në të dy rastet, 57.1% e komunave rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme.

Gjetja më problematike e Dimensionit 6 lidhet me monitorimin e cilësisë së ofruesve. Për këtë indikator nuk është evidentuar asnjë rast me evidencë primare. 42.9% e komunave kanë vetëm evidencë sekondare, ndërsa 57.1% rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme. Kjo tregon se edhe aty ku komunat deklarojnë se monitorojnë cilësinë e ofruesve të kontraktuar, procesi nuk dokumentohet në mënyrë të mjaftueshme.

Në nivel ndër sektorial, monitorimi tregon se dallimi ndërmjet përmbushjes së evidentuar dhe përmbushjes së dokumentuar me evidencë primare është një nga çështjet kryesore të sistemit. Në një numër të konsiderueshëm indikatorësh, rezultatet pozitive mbështeten pjesërisht ose kryesisht në evidencë sekondare.

Për këtë arsye, një nga gjetjet kryesore të raportit është se sfida komunale nuk lidhet vetëm me faktin nëse një përgjegjësi zbatohet, por edhe me aftësinë e komunave për ta formalizuar, dokumentuar dhe bërë të verifikueshëm zbatimin e saj.

Krahasimi me Raportin Vjetor 2025 të MAPL-së për zbatimin e politikave komunale në fushën e të drejtave të njeriut[1] e përforcon këtë përfundim. Edhe ai raport evidenton se strukturat komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ekzistojnë në një numër të konsiderueshëm komunash, por funksionalizimi dhe raportimi i rezultateve mbeten të pabarabarta.

Në raportin e vitit 2025, nga 29 komuna raportuese, 16 kishin deklaruar se kanë hartuar Planin e Punës së Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, ndërsa 15 kishin raportuar se plani ishte miratuar nga Kuvendi Komunal. Po ashtu, të dhënat për aktivitetet e realizuara dhe sidomos për financimin e tyre ishin të kufizuara.

Kjo përputhet me gjetjet e monitorimit aktual: strukturat dhe planet janë më të pranishme sesa zbatimi konkret, financimi dhe dokumentimi sistematik i rezultateve.

Në tërësi, sa më shumë që përgjegjësia kalon nga formalizimi institucional drejt ofrimit konkret të shërbimeve, financimit dhe kontrollit të cilësisë, aq më të mëdha bëhen boshllëqet. Prandaj, sfida për periudhën e ardhshme nuk është vetëm krijimi i strukturave të reja, por funksionalizimi i atyre ekzistuese, sigurimi i shërbimeve konkrete, financimi i qëndrueshëm dhe rritja e nivelit të dokumentimit institucional të rezultateve.

1] https://mapl.rks-gov.net/raportet-vjetore-te-mapl-se/

QASJA NË ZBATIM | *METODOLOGJIA*

Procesi i monitorimit është zhvilluar në disa faza të ndërlidhura, me qëllim që të sigurohet një vlerësim sa më i krahasueshëm, objektiv dhe i verifikueshëm i përmbushjes së përgjegjësive komunale në fushën e shërbimeve sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve.

Në versionin fillestar të metodologjisë, vlerësimi ishte konceptuar të mbështetej kryesisht në evidencë primare, përkatësisht në dokumente zyrtare dhe burime të drejtpërdrejta institucionale që mundësojnë verifikimin e përmbushjes së secilit indikator. Kjo qasje kishte për qëllim të siguronte një standard të lartë të verifikueshmërisë dhe krahasueshmërisë së rezultateve.

Megjithatë, gjatë testimit praktik të instrumentit në kuadër të trajnimit të monitoruesve, si dhe gjatë komunikimit dhe konsultimit me komunat, u evidentuan raste kur komunat deklaronin përmbushjen e një përgjegjësie, por dokumentacioni primar nuk ishte i publikuar, nuk ishte i disponueshëm në momentin e monitorimit ose nuk ishte ofruar në formë të mjaftueshme për verifikim të plotë. Nëse këto raste do të klasifikoheshin automatikisht si të papërmbushura, analiza do të humbiste një pjesë të rëndësishme të informacionit të siguruar gjatë procesit të verifikimit.

Për këtë arsye, gjatë operacionalizimit të metodologjisë është shtuar edhe kategoria e të dhënave sekondare. Kjo kategori nuk është trajtuar si e barabartë me evidencën primare, por si një nivel i veçantë i evidencës, që mundëson evidentimin e rasteve kur komuna konfirmon përmbushjen, por nuk ofron dokumentacion primar të mjaftueshëm. Ky plotësim i metodologjisë ka mundësuar dallimin më të qartë ndërmjet përmbushjes së dokumentuar, përmbushjes së deklaruar dhe mungesës së një baze të mjaftueshme për të konstatuar përmbushjen.

Në fazën e parë është realizuar monitorimi i ueb-faqeve zyrtare dhe i dokumentacionit publik të 38 komunave. Për secilin indikator janë kërkuar informata dhe dokumente relevante, përfshirë vendime, plane, raporte, dokumente buxhetore, kontrata, lista, procesverbale dhe dokumente të tjera institucionale.

Në fazën e dytë, rezultatet preliminare të monitorimit u janë dërguar komunave për verifikim dhe raportim. Për secilën përgjigje pozitive është kërkuar që komuna të ofrojë evidencë mbështetëse. Nga 38 komunat e përfshira në proces, 28 komuna kanë kthyer përgjigje, ndërsa 10 komuna nuk kanë marrë pjesë në fazën e verifikimit.

Në fazën e tretë është realizuar kontrolli i cilësisë së të dhënave, duke krahasuar informacionin e identifikuar gjatë monitorimit publik me përgjigjet dhe evidencën e ofruar nga komunat. Qëllimi ka qenë që të bëhet dallimi ndërmjet përmbushjes së dokumentuar dhe asaj të deklaruar pa evidencë të mjaftueshme.

Në bazë të këtij procesi, të dhënat janë klasifikuar në tri kategori:

- Të dhëna primare (1) – përmbushja është mbështetur me evidencë të drejtpërdrejtë, dokumentare dhe të verifikueshme;
- Të dhëna sekondare (2) – komuna ka deklaruar ose konfirmuar përmbushjen, por nuk ka ofruar evidencë primare të mjaftueshme për verifikim të plotë;
- Pa përmbushje të verifikueshme (0) – gjatë procesit të monitorimit dhe verifikimit nuk është siguruar bazë e mjaftueshme për të konstatuar përmbushjen.

Ky klasifikim mundëson që analiza të mos kufizohet vetëm në pyetjen nëse një përgjegjësi është raportuar si e përmbushur, por të vlerësojë edhe cilësinë dhe fuqinë e evidencës që e mbështet atë. Vetë raporti aktual e përdor këtë dallim ndërmjet evidencës primare, sekondare dhe rasteve pa përmbushje të verifikueshme.

Për rangimin e përgjithshëm të komunave është përdorur një qasje e peshimit te të dhënave, ku evidenca primare vlerësohet me 1 pikë, evidenca sekondare me 0.5 pikë, ndërsa mungesa e evidencës me 0 pikë. Në këtë mënyrë, evidenca sekondare merret në konsideratë, por nuk barazohet me evidencën e drejtpërdrejtë dhe të verifikueshme. Në rast të rezultateve të barabarta, përparësi i jepet komunës me numër më të madh të indikatorëve të mbështetur me evidencë primare.

Kjo qasje mundëson që metodologjia të matë njëkohësisht nivelin e përmbushjes së përgjegjësive komunale dhe nivelin e dokumentimit institucional të tyre, duke pasqyruar më saktë realitetin e identifikuar gjatë monitorimit, testimit të instrumentit dhe konsultimit me komunat.

DIMENSIONI 1: MEKANIZMAT INSTITUCIONALË

1. Përmbledhje e përgjithshme

Dimensioni "Mekanizmat institucionalë" vlerëson nivelin në të cilin komunat kanë krijuar, formalizuar dhe funksionalizuar mekanizmat bazë institucionalë për mbrojtjen e fëmijës. Në Dimensionin 1 janë vlerësuar gjithsej 112 raste, të ndara në katër indikatorë për 28 komunat që kanë marrë pjesë në fazën e verifikimit. Nga këto, 43 raste janë mbështetur me të dhëna primare (38.4%), 25 me të dhëna sekondare (22.3%), ndërsa 44 raste (39.3%) kanë rezultuar pa përmbushje të verifikueshme. Në total, 68 raste ose 60.7% rezultojnë të përmbushura.

Rezultati më i lartë është evidentuar te Ekipi për të Drejtat e Fëmijës, ku 23 nga 28 komuna, ose 82.1%, rezultojnë me përmbushje. Prej tyre, 17 raste mbështeten me evidencë primare dhe 6 me të dhëna sekondare. Ky është një tregues se mekanizmi është themeluar në shumicën e komunave.

Megjithatë, takimet e Ekipit gjatë vitit 2025 rezultojnë me përmbushje dukshëm më të ulët, prej 53.6%. Vetëm 15 nga 28 komunat kanë dëshmuar ose deklaruar se Ekipi ka zhvilluar takime, prej të cilave 10 me evidencë primare dhe 5 me të dhëna sekondare. Diferenca ndërmjet themelimit të Ekipit dhe funksionimit të tij tregon se ekzistenca formale e mekanizmit nuk shoqërohet gjithmonë me funksionim të rregullt.

Indikatori për zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës rezulton me 64.3% përmbushje, ndërsa rezultati më i ulët paraqitet te zyrtari i specializuar në QPS, me vetëm 42.9% përmbushje.

Në përgjithësi, Dimensioni 1 tregon se mekanizmat bazë institucionalë janë relativisht të zhvilluar, por dobësitë shfaqen në funksionalizimin e tyre dhe në kapacitetet profesionale të specializuara. Sfida kryesore nuk është vetëm themelimi i mekanizmave, por sigurimi që ata të funksionojnë rregullisht dhe të kenë kapacitetet e nevojshme për ushtrimin e përgjegjësive.

Në kuadër të këtij dimensioni janë analizuar katër elemente kryesore:
1. caktimi i zyrtarit përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës;
2. ekzistenca e zyrtarit të specializuar për mbrojtjen e fëmijës në Qendrën për Punë Sociale;
3. themelimi dhe funksionaliteti i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës;
4. funksionimi i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, i vlerësuar përmes mbajtjes së takimeve gjatë vitit 2025.

Metodologjia e monitorimit përcakton zyrtarin përgjegjës, zyrtarin e specializuar në QPS dhe Ekipin për të Drejtat e Fëmijës si mekanizma kryesorë institucionalë në nivel komunal.
Vlerësimi përfshin 28 komuna. Me katër elemente të vlerësuara për secilën komunë, janë analizuar gjithsej 112 raste individuale.

Nga 112 rastet:
- 43 raste, ose 38.4%, janë të mbështetura me të dhëna primare;
- 25 raste, ose 22.3%, janë të mbështetura me të dhëna sekondare;
- 44 raste, ose 39.3%, rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme.

Në total, duke marrë së bashku të dhënat primare dhe sekondare, 68 nga 112 raste, ose 60.7%, rezultojnë me përmbushje.

Rezultatet tregojnë se në shumicën e rasteve është konstatuar ekzistenca ose funksionimi i mekanizmave institucionalë. Megjithatë, niveli i dokumentimit institucional mbetet dukshëm më i ulët: vetëm 38.4% e të gjitha rasteve mbështeten me evidencë primare.

Njëkohësisht, rezultatet tregojnë një dallim të qartë ndërmjet themelimit formal të mekanizmave, kapaciteteve profesionale dhe funksionimit të tyre praktik. Ekipi për të Drejtat e Fëmijës paraqet mekanizmin me nivelin më të lartë të përmbushjes, ndërsa zyrtari i specializuar në QPS rezulton me nivelin më të ulët.

1.1. Përmbushja sipas indikatorëve dhe përgjegjësive institucionale

1.1.1. Zyrtari përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës

Indikatori vlerëson nëse komuna ka caktuar zyrtar përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës.

Metodologjia e monitorimit parasheh që përmbushja të verifikohet përmes dokumentacionit institucional përkatës, përfshirë vendimin për caktimin e zyrtarit.

Nga 28 komunat:
- 11 komuna – 39.3% kanë të dhëna primare;
- 7 komuna – 25.0% kanë të dhëna sekondare;
- 10 komuna – 35.7% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, 18 nga 28 komuna, ose 64.3%, rezultojnë me përmbushje të indikatorit.

Rezultati tregon se caktimi i zyrtarit përgjegjës është realizuar në shumicën e komunave. Megjithatë, vetëm në 11 komuna përmbushja është dëshmuar përmes dokumentacionit primar, ndërsa në shtatë komuna të tjera është konstatuar përmes burimeve sekondare.

Kjo diferencë tregon se sfida nuk lidhet vetëm me caktimin e zyrtarit, por edhe me formalizimin dhe disponueshmërinë e dokumentacionit institucional që dëshmon caktimin.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë për këtë indikator lidhen me:
- Kryetarin e Komunës;
- Drejtorinë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Për secilin prej këtyre institucioneve, nga 28 raste të mundshme:
- 11 raste – 39.3% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar dhe të mbështetur me evidencë primare;
- 7 raste – 25.0% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 10 raste – 35.7% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, si për Kryetarin e Komunës ashtu edhe për DSHMS-në, përgjegjësia e lidhur me këtë indikator rezulton e përmbushur në 18 nga 28 raste, ose 64.3%.

1.1. 2. Zyrtari i specializuar për mbrojtjen e fëmijës në QPS

Ky indikator vlerëson nëse Qendra për Punë Sociale ka zyrtar të specializuar për mbrojtjen e fëmijës.

Nga 28 komunat:
- 5 komuna – 17.9% kanë të dhëna primare;
- 7 komuna – 25.0% kanë të dhëna sekondare;
- 16 komuna – 57.1% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, vetëm 12 nga 28 komuna, ose 42.9%, rezultojnë me përmbushje të indikatorit.

Ky është indikatori me nivelin më të ulët të përmbushjes në Dimensionin 1.

Veçanërisht i ulët është niveli i të dhënave primare: vetëm pesë komuna kanë evidencë të drejtpërdrejtë që mbështet përmbushjen.

Rezultati evidenton një dobësi të rëndësishme në sigurimin dhe dokumentimin e kapaciteteve profesionale të specializuara për mbrojtjen e fëmijës në kuadër të QPS-ve.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë për këtë indikator lidhen me:
- Drejtorinë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- Qendrën për Punë Sociale.

Për secilin prej këtyre institucioneve:
- 5 raste – 17.9% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar dhe të mbështetur me evidencë primare;
- 7 raste – 25.0% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 16 raste – 57.1% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia e lidhur me indikatorin rezulton e përmbushur në 12 nga 28 raste, ose 42.9%, si për DSHMS-në ashtu edhe për QPS-në.

Ky rezultat paraqet boshllëkun më të madh institucional të dimensionit.

1.1. 3. Ekipi për të Drejtat e Fëmijës

Indikatori vlerëson nëse Ekipi për të Drejtat e Fëmijës është themeluar dhe funksional.

Nga 28 komunat:
- 17 komuna – 60.7% kanë të dhëna primare;
- 6 komuna – 21.4% kanë të dhëna sekondare;
- 5 komuna – 17.9% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, 23 nga 28 komuna, ose 82.1%, rezultojnë me përmbushje.

Ky është indikatori me nivelin më të lartë të përmbushjes në Dimensionin 1. Gjithashtu, ky indikator ka edhe nivelin më të lartë të evidencës primare: në 17 nga 28 komuna ekzistenca e mekanizmit mbështetet me dokumentacion të drejtpërdrejtë institucional.

Kjo tregon se themelimi i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës është mekanizmi më i konsoliduar institucionalisht në kuadër të dimensionit.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë për këtë indikator lidhen me:
- Kryetarin e Komunës;
- Drejtorinë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- Qendrën për Punë Sociale;
- Drejtorinë Komunale të Arsimit.

Për secilin institucion:
- 17 raste – 60.7% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar dhe të mbështetur me evidencë primare;
- 6 raste – 21.4% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 5 raste – 17.9% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, për secilin nga katër institucionet, përgjegjësia e lidhur me këtë indikator rezulton e përmbushur në 23 nga 28 raste, ose 82.1%.

Rezultati tregon nivel relativisht të lartë të formalizimit institucional. Megjithatë, funksionimi praktik i Ekipit duhet të analizohet përmes indikatorit vijues.

1.1. 4. Takimet e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës gjatë vitit 2025

Ky indikator vlerëson funksionimin praktik të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës përmes mbajtjes së takimeve gjatë vitit 2025.

Nga 28 komunat:
- 10 komuna – 35.7% kanë të dhëna primare;
- 5 komuna – 17.9% kanë të dhëna sekondare;
- 13 komuna – 46.4% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, 15 nga 28 komuna, ose 53.6%, rezultojnë me përmbushje. Ky rezultat është dukshëm më i ulët se rezultati për themelimin e Ekipit. Ndërsa në 23 komuna është konstatuar ekzistenca e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, vetëm në 15 komuna është konstatuar mbajtja e takimeve gjatë vitit 2025.

Kjo krijon një diferencë prej tetë komunash, e cila evidenton një hendek të rëndësishëm ndërmjet ekzistencës formale dhe funksionimit praktik të mekanizmit.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë për këtë indikator lidhen me:
- Kryetarin e Komunës;
- Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.

Për secilin:
- 10 raste – 35.7% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar dhe të mbështetur me evidencë primare;
- 5 raste – 17.9% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 13 raste – 46.4% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia rezulton e përmbushur në 15 nga 28 raste, ose 53.6%, si për Kryetarin e Komunës ashtu edhe për Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.

Rezultati tregon se funksionaliteti i mekanizmit është dukshëm më i dobët sesa themelimi formal i tij.

Tabela 1 - Përmbledhje e përgjegjësive institucionale

Në nivel të Dimensionit 1, përgjegjësitë institucionale janë të shpërndara ndërmjet pesë aktorëve kryesorë.

Institucioni përgjegjës	Përgjegjësitë	Me evidencë primare	Sipas të dhënave sekondare	Pa përmbushje	Gjithsej të përmbushura
Kryetari i Komunës	84	38 (45.2%)	18 (21.4%)	28 (33.3%)	56 (66.7%)
DSHMS	84	33 (39.3%)	20 (23.8%)	31 (36.9%)	53 (63.1%)
QPS	56	22 (39.3%)	13 (23.2%)	21 (37.5%)	35 (62.5%)
DKA	28	17 (60.7%)	6 (21.4%)	5 (17.9%)	23 (82.1%)
Ekipi për të Drejtat e Fëmijës	28	10 (35.7%)	5 (17.9%)	13 (46.4%)	15 (53.6%)

Nga kjo shpërndarje rezulton se Kryetari i Komunës, DSHMS-ja dhe QPS-ja kanë përgjegjësi më të gjera dhe më të shpërndara në kuadër të dimensionit.

Kryetari i Komunës ka nivel të përgjithshëm të përmbushjes prej 66.7%, DSHMS-ja 63.1%, ndërsa QPS-ja 62.5%.

DKA-ja ka nivelin më të lartë formal të përmbushjes, 82.1%, por ky rezultat duhet interpretuar duke pasur parasysh se DKA-ja lidhet vetëm me një indikator.

Në anën tjetër, Ekipi për të Drejtat e Fëmijës ka 53.6% përmbushje në përgjegjësinë që lidhet me funksionimin e tij, çka konfirmon se sfida kryesore mbetet kalimi nga themelimi formal drejt funksionimit të rregullt.

Renditja është bërë sipas kësaj logjike:
1. numri më i madh i të dhënave primare;
2. në rast barazimi, numri më i madh i të dhënave sekondare;
3. më pas, numri më i vogël i rasteve pa përmbushje.

Tabela 2 – përmbledhja e përmbushjes sipas indikatorit 1

Rangimi	Komuna	Zyrtari për mbrojtjen e fëmijës	Zyrtari i specializuar në QPS	Ekipi për të Drejtat e Fëmijës	Takimet e Ekipit 2025	Primare	Sekondare	Pa përmbushje	Përmbushja
1	Hani i Elezit	1	1	1	1	4	0	0	100%
1	Suharekë	1	1	1	1	4	0	0	100%
2	Lipjan	1	1	1	2	3	1	0	100%
2	Rahovec	2	1	1	1	3	1	0	100%
3	Gjakovë	1	0	1	1	3	0	1	75%
3	Istog	1	0	1	1	3	0	1	75%
4	Junik	1	2	1	2	2	2	0	100%
4	Pejë	2	2	1	1	2	2	0	100%
5	Shtime	2	0	1	1	2	1	1	75%
6	Dragash	1	0	1	0	2	0	2	50%
6	Gjilan	1	0	1	0	2	0	2	50%
6	Klinë	1	0	1	0	2	0	2	50%
6	Obiliq	0	0	1	1	2	0	2	50%
6	Prishtinë	0	1	1	0	2	0	2	50%
6	Prizren	0	0	1	1	2	0	2	50%
6	Vushtrri	1	0	1	0	2	0	2	50%
7	Ferizaj	1	0	2	0	1	1	2	50%
7	Viti	0	0	2	1	1	1	2	50%

8	Graçanicë	0	0	1	0	1	0	3	25%
9	Fushë Kosovë	0	2	2	2	0	3	1	75%
9	Skënderaj	2	2	2	0	0	3	1	75%
10	Gllogoc	0	0	2	2	0	2	2	50%
10	Kamenicë	0	0	2	2	0	2	2	50%
10	Mamushë	2	2	0	0	0	2	2	50%
10	Mitrovicë e Jugut	2	2	0	0	0	2	2	50%
10	Podujevë	2	2	0	0	0	2	2	50%
11	Mitrovicë e Veriut	0	0	0	0	0	0	4	0%
11	Ranillug	0	0	0	0	0	0	4	0%

Në krye të renditjes janë Suhareka dhe Hani i Elezit, ku të katër rastet e vlerësimit janë të mbështetura me evidencë primare.

Lipjani dhe Rahoveci kanë gjithashtu përmbushje të plotë, por me tri të dhëna primare dhe një sekondare.

Peja dhe Juniku rezultojnë me përmbushje 100%, por me dy indikatorë të mbështetur me të dhëna primare dhe dy me të dhëna sekondare.

Një profil tjetër paraqesin Fushë Kosova dhe Skënderaj. Të dyja kanë përmbushje prej 75%, por të tre rastet e përmbushura mbështeten vetëm me të dhëna sekondare. Kjo tregon dallimin ndërmjet nivelit të përmbushjes dhe fuqisë së evidencës që mbështet përmbushjen.

Në fund të renditjes janë Mitrovica e Veriut dhe Ranillugu, ku nuk është konstatuar përmbushje e verifikueshme në asnjërin prej katër elementeve të Dimensionit 1.

Në interpretimin e renditjes duhet të dallohen dy elemente:
- niveli i përmbushjes, që përfshin si të dhënat primare ashtu edhe ato sekondare;
- niveli i dokumentimit, ku përparësi kanë rastet e mbështetura me evidencë primare.

Për këtë arsye, një komunë me përmbushje të plotë të bazuar kryesisht në të dhëna sekondare renditet pas një komune me numër më të madh të indikatorëve të dëshmuar me evidencë primare.

DIMENSIONI 2: PLANIFIKIMI DHE POLITIKAT

2. Përmbledhje e përgjithshme

Dimensioni "Planifikimi dhe Politikat" vlerëson nivelin në të cilin komunat kanë krijuar bazën planifikuese dhe programore për mbrojtjen e fëmijëve dhe zhvillimin e shërbimeve sociale. Në Dimensionin 2 janë vlerësuar gjithsej 112 raste, të ndara në katër indikatorë për 28 komunat që kanë marrë pjesë në fazën e verifikimit. Nga këto, 41 raste janë mbështetur me të dhëna primare (36.6%), 23 me të dhëna sekondare (20.5%), ndërsa 48 raste (42.9%) kanë rezultuar pa përmbushje të verifikueshme. Në total, 64 raste ose 57.1% rezultojnë të përmbushura.

Rezultati më i lartë është evidentuar te konsultimi me OJQ dhe aktorë lokalë, ku 20 nga 28 komunat, ose 71.4%, rezultojnë me përmbushje. Prej tyre, 12 raste janë të mbështetura me evidencë primare dhe 8 me të dhëna sekondare. Ky rezultat tregon se përfshirja e aktorëve lokalë është elementi më i zhvilluar i planifikimit komunal.

Indikatori për planin vjetor për mbrojtjen e fëmijës rezulton me 57.1% përmbushje, përkatësisht 16 nga 28 komuna. Në këtë indikator evidenca është relativisht më e fortë, pasi 12 raste mbështeten me të dhëna primare dhe vetëm 4 me të dhëna sekondare.

Rezultatet më të ulëta paraqiten te planifikimi social i bazuar në analiza të nevojave dhe te programet për mirëqenien e fëmijëve, të dyja me nga 50% përmbushje. Te planifikimi social, 9 raste janë primare dhe 5 sekondare, ndërsa te programet për fëmijë 8 raste janë primare dhe 6 sekondare.

Kjo tregon se komunat janë relativisht më të avancuara në organizimin e konsultimeve dhe në hartimin e dokumenteve formale, ndërsa paraqesin më shumë vështirësi në lidhjen e planifikimit me analizën e nevojave dhe në zhvillimin e programeve konkrete për mirëqenien e fëmijëve.

Një element tjetër i rëndësishëm është cilësia e dokumentimit. Edhe pse përmbushja e përgjithshme arrin 57.1%, vetëm 36.6% e të gjitha rasteve të vlerësuara mbështeten me evidencë primare. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e përmbushjes vazhdon të mbështetet në deklarimet e komunave dhe jo në dokumentacion të plotë verifikues.

Në përgjithësi, Dimensioni 2 tregon një nivel mesatar të përmbushjes, me rezultate më të mira në konsultim dhe më të dobëta në planifikimin e bazuar në nevoja dhe në zhvillimin e programeve. Sfida kryesore mbetet që proceset formale të planifikimit të lidhen më drejtpërdrejt me analizat e nevojave, prioritetet konkrete dhe programet për fëmijët.

Në kuadër të këtij dimensioni janë analizuar katër indikatorë:
1. ekzistenca e planit për mbrojtjen e fëmijës;
2. përfshirja e OJQ-ve dhe aktorëve lokalë në procesin e planifikimit;
3. planifikimi social i bazuar në analiza të nevojave;
4. zhvillimi i programeve komunale për mirëqenien e fëmijëve.

Matrica e monitorimit i trajton këta indikatorë si pjesë të planifikimit dhe politikave komunale dhe përcakton përgjegjësi të ndara ndërmjet Kryetarit të Komunës, DSHMS-së, QPS-së, DKA-së dhe Ekipit për të Drejtat e Fëmijës.

Vlerësimi përfshin 28 komuna. Me katër indikatorë për secilën komunë, janë analizuar gjithsej 112 raste individuale.

Nga 112 rastet:
- 41 raste, ose 36.6%, janë të mbështetura me të dhëna primare;
- 23 raste, ose 20.5%, janë të mbështetura me të dhëna sekondare;
- 48 raste, ose 42.9%, rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme.

Në total, duke marrë së bashku të dhënat primare dhe sekondare, 64 nga 112 raste, ose 57.1%, rezultojnë me përmbushje.

Rezultatet tregojnë se niveli i përgjithshëm i përmbushjes në këtë dimension është pak më i ulët se në Dimensionin 1. Gjithashtu, vetëm rreth një e treta e të gjitha rasteve janë të mbështetura me evidencë primare.

Performanca ndryshon dukshëm ndërmjet indikatorëve. Konsultimi me OJQ dhe aktorë lokalë paraqet nivelin më të lartë të përmbushjes, ndërsa planifikimi social i bazuar në analiza të nevojave dhe programet për fëmijë kanë rezultatet më të ulëta.

Kjo tregon se sfida kryesore nuk lidhet vetëm me ekzistencën e dokumenteve planifikuese, por edhe me cilësinë e planifikimit, bazimin e tij në nevoja konkrete dhe përkthimin e planeve në programe të zbatueshme.

2.1 Përmbushja sipas indikatorëve dhe përgjegjësive institucionale

2.1.1. Plani për mbrojtjen e fëmijës

Indikatori vlerëson nëse komuna ka plan për mbrojtjen e fëmijës.

Nga 28 komunat:
- 12 komuna – 42.9% kanë të dhëna primare;
- 4 komuna – 14.3% kanë të dhëna sekondare;
- 12 komuna – 42.9% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, 16 nga 28 komuna, ose 57.1%, rezultojnë me përmbushje të indikatorit.

Rezultati tregon se pak më shumë se gjysma e komunave kanë një formë të planifikimit të identifikuar për mbrojtjen e fëmijës. Pozitiv është fakti se pjesa më e madhe e rasteve të përmbushura mbështeten me të dhëna primare.

Megjithatë, 12 komuna rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme, duke treguar se planifikimi formal për mbrojtjen e fëmijëve nuk është ende i konsoliduar në të gjitha komunat.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë për këtë indikator lidhen me:
- Kryetarin e Komunës;
- Drejtorinë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- Qendrën për Punë Sociale;
- Drejtorinë Komunale të Arsimit;
- Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.

Për secilin prej këtyre institucioneve, nga 28 raste të mundshme:
- 12 raste – 42.9% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar dhe të mbështetur me evidencë primare;
- 4 raste – 14.3% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 12 raste – 42.9% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia e lidhur me këtë indikator rezulton e përmbushur në 16 nga 28 raste, ose 57.1%, për secilin institucion përgjegjës.

2.1.2. Konsultimi me OJQ dhe aktorë lokalë

Indikatori vlerëson nëse OJQ-të dhe aktorët lokalë janë përfshirë në procesin e planifikimit.
Nga 28 komunat:
- 12 komuna – 42.9% kanë të dhëna primare;
- 8 komuna – 28.6% kanë të dhëna sekondare;
- 8 komuna – 28.6% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, 20 nga 28 komuna, ose 71.4%, rezultojnë me përmbushje.

Ky është indikatori me nivelin më të lartë të përmbushjes në Dimensionin 2.

Rezultati sugjeron se praktika e përfshirjes së aktorëve lokalë është relativisht e përhapur. Megjithatë, tetë nga rastet e përmbushura mbështeten vetëm në të dhëna sekondare.

Kjo tregon nevojën për dokumentim më sistematik të proceseve të konsultimit, përmes listave të pjesëmarrjes, procesverbaleve, raporteve të konsultimit dhe dokumentimit të komenteve të pranuara.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë lidhen me:
- Kryetarin e Komunës;
- DSHMS-në;
- QPS-në;
- Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.

Për secilin institucion:
- 12 raste – 42.9% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar me evidencë primare;
- 8 raste – 28.6% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 8 raste – 28.6% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia rezulton e përmbushur në 20 nga 28 raste, ose 71.4%.

2.1.3. Planifikimi social i bazuar në analizën e nevojave

Ky indikator vlerëson nëse planifikimi social i komunës bazohet në analiza të nevojave.

Nga 28 komunat:
- 9 komuna – 32.1% kanë të dhëna primare;
- 5 komuna – 17.9% kanë të dhëna sekondare;
- 14 komuna – 50.0% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, 14 nga 28 komuna, ose 50.0%, rezultojnë me përmbushje.

Rezultati tregon se vetëm gjysma e komunave kanë dëshmi se planifikimi social është bazuar në analiza të nevojave.

Vetëm në nëntë komuna kjo mbështetet me evidencë primare. Ky rezultat përbën një nga dobësitë kryesore të dimensionit, sepse planifikimi social duhet të mbështetet në identifikimin e nevojave reale të komunitetit dhe të grupeve të cenueshme.

Në mungesë të analizës së nevojave rritet rreziku që prioritetet, shërbimet dhe financimi të mos adresojnë në mënyrë të mjaftueshme kërkesën reale në nivel lokal.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë lidhen me:
- DSHMS-në;
- QPS-në;
- Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.

Për secilin institucion:
- 9 raste – 32.1% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar me evidencë primare;
- 5 raste – 17.9% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 14 raste – 50.0% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia rezulton e përmbushur në 14 nga 28 raste, ose 50.0%.

2.1.4. Programet komunale për mirëqenien e fëmijëve

Indikatori vlerëson nëse komuna zhvillon programe konkrete për mirëqenien e fëmijëve.

Nga 28 komunat:
- 8 komuna – 28.6% kanë të dhëna primare;
- 6 komuna – 21.4% kanë të dhëna sekondare;
- 14 komuna – 50.0% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, 14 nga 28 komuna, ose 50.0%, rezultojnë me përmbushje.

Ky indikator ka nivelin më të ulët të evidencës primare në Dimensionin 2.

Rezultati tregon se kalimi nga planifikimi në programe konkrete për mirëqenien e fëmijëve mbetet sfidë për një pjesë të madhe të komunave. Në gjysmën e komunave nuk është konstatuar përmbushje e verifikueshme, ndërsa vetëm në tetë komuna janë evidentuar të dhëna primare.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë lidhen me:
- Kryetarin e Komunës;
- DSHMS-në;
- QPS-në;
- DKA-në;
- Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.

Për secilin institucion:
- 8 raste – 28.6% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar me evidencë primare;
- 6 raste – 21.4% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 14 raste – 50.0% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia e lidhur me këtë indikator rezulton e përmbushur në 14 nga 28 raste, ose 50.0%.

Tabela 3 - Përmbledhje e përgjegjësive institucionale

Në nivel të Dimensionit 2, përgjegjësitë janë të shpërndara ndërmjet pesë institucioneve kryesore.

Institucioni përgjegjës	Raste të mundshme	Me evidencë primare	Sipas të dhënave sekondare	Pa përmbushje	Gjithsej të përmbushura
Kryetari i Komunës	84	32 (38.1%)	18 (21.4%)	34 (40.5%)	50 (59.5%)
DSHMS	112	41 (36.6%)	23 (20.5%)	48 (42.9%)	64 (57.1%)
QPS	112	41 (36.6%)	23 (20.5%)	48 (42.9%)	64 (57.1%)
DKA	56	20 (35.7%)	10 (17.9%)	26 (46.4%)	30 (53.6%)
Ekipi për të Drejtat e Fëmijës	112	41 (36.6%)	23 (20.5%)	48 (42.9%)	64 (57.1%)

Kryetari i Komunës lidhet me tri nga katër fushat e vlerësimit dhe arrin nivel të përgjithshëm të përmbushjes prej 59.5%.DSHMS-ja, QPS-ja dhe Ekipi për të Drejtat e Fëmijës janë të përfshirë gjerësisht në dimension dhe rezultojnë me nivel të përgjithshëm përmbushjeje prej 57.1%.

DKA-ja lidhet me dy indikatorë dhe ka nivel përmbushjeje prej 53.6%.Në të gjitha institucionet vërehet se një pjesë e konsiderueshme e përgjegjësive rezultojnë të zbatuara vetëm sipas të dhënave sekondare ose mbeten pa përmbushje të verifikueshme.

Tabela 4 – përmbledhja e përmbushjes sipas indikatorit 2

Rangimi	Komuna	Plan vjetor	Konsultimi	Planifikimi social	Programet për fëmijë	Primare	Sekondare	Pa përmbushje	Gjithsej të përmbushura	Përmbushja
1	Lipjan	1	1	1	1	4	0	0	4/4	100%
1	Obiliq	1	1	1	1	4	0	0	4/4	100%
1	Prizren	1	1	1	1	4	0	0	4/4	100%
1	Suharekë	1	1	1	1	4	0	0	4/4	100%
2	Dragash	1	1	1	2	3	1	0	4/4	100%
3	Gjakovë	1	1	0	1	3	0	1	3/4	75%
3	Shtime	1	1	1	0	3	0	1	3/4	75%
3	Hani i Elezit	1	1	0	1	3	0	1	3/4	75%
4	Junik	1	2	2	1	2	2	0	4/4	100%
5	Mitrovicë e	1	0	1	2	2	1	1	3/4	75%
6	Gjilan	1	1	0	0	2	0	2	2/4	50%
6	Istog	1	0	1	0	2	0	2	2/4	50%
6	Prishtinë	0	1	1	0	2	0	2	2/4	50%
6	Rahovec	0	1	0	1	2	0	2	2/4	50%
7	Vushtrri	0	1	0	0	1	0	3	1/4	25%
8	Kamenicë	2	2	2	2	0	4	0	4/4	100%
8	Pejë	2	2	2	2	0	4	0	4/4	100%
9	Gllogoc	2	2	2	0	0	3	1	3/4	75%
9	Mitrovicë e Veriut	0	2	2	2	0	3	1	3/4	75%
10	Skënderaj	2	2	0	0	0	2	2	2/4	50%
11	Klinë	0	2	0	0	0	1	3	1/4	25%

11	Fushë Kosovë	0	0	0	2	0	1	3	1/4	25%
11	Viti	0	2	0	0	0	1	3	1/4	25%
12	Podujevë	0	0	0	0	0	0	4	0/4	0%
12	Ferizaj	0	0	0	0	0	0	4	0/4	0%
12	Mamushë	0	0	0	0	0	0	4	0/4	0%
12	Graçanicë	0	0	0	0	0	0	4	0/4	0%
12	Ranillug	0	0	0	0	0	0	4	0/4	0%

Në krye të renditjes janë Lipjani, Obiliqi, Prizreni dhe Suhareka, të cilat kanë të katër indikatorët të mbështetur me të dhëna primare.

Dragashi gjithashtu ka përmbushje 100%, me tri të dhëna primare dhe një të dhënë sekondare.

Juniku ka po ashtu përmbushje të plotë, por struktura e evidencës është dy të dhëna primare dhe dy sekondare.

Një profil i veçantë paraqesin Kamenica dhe Peja. Të dyja kanë përmbushje 100%, por të katër indikatorët mbështeten me të dhëna sekondare. Për këtë arsye renditen pas komunave që kanë evidencë primare.

Në fund të renditjes janë Podujeva, Ferizaj, Mamusha, Graçanica dhe Ranillugu, ku nuk është konstatuar përmbushje e verifikueshme në asnjërin prej katër indikatorëve.

DIMENSIONI 3: OFRIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE

3. Përmbledhje e përgjithshme

Dimensioni "Ofrimi i Shërbimeve Sociale" vlerëson nivelin në të cilin komunat sigurojnë informacion të qasshëm për shërbimet sociale, funksionimin e Qendrës për Punë Sociale si pikë informimi për qytetarët dhe disponueshmërinë e standardeve mbi bazën e të cilave ofrohen shërbimet sociale. Në Dimensionin 3 janë vlerësuar gjithsej 84 raste, të ndara në tre indikatorë për 28 komuna. Nga këto, 26 raste janë mbështetur me të dhëna primare (31.0%), 26 raste me të dhëna sekondare (31.0%), ndërsa 32 raste (38.1%) kanë rezultuar pa përmbushje të verifikueshme. Në total, 52 nga 84 raste, ose 61.9%, rezultojnë të përmbushura.
Rezultati më i lartë është evidentuar te funksioni i Qendrës për Punë Sociale si qendër informimi për qytetarët, ku 19 nga 28 komunat, ose 67.9%, rezultojnë me përmbushje. Prej tyre, 10 raste mbështeten me evidencë primare dhe 9 me të dhëna sekondare.

Indikatori që lidhet me standardet minimale të shërbimeve sociale arrin 60.7% përmbushje, ndërsa lista publike e shërbimeve sociale rezulton me 57.1%.

Dimensioni 3 ka përmbushjen më të lartë ndër gjashtë dimensionet e monitoruara. Megjithatë, një karakteristikë e rëndësishme është se të dhënat primare dhe sekondare janë të barabarta, me nga 31%. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e përmbushjes vazhdon të mbështetet në konfirmimet e komunave dhe jo në dokumentacion të drejtpërdrejtë.

Në përgjithësi, rezultati tregon se funksioni informues dhe organizimi bazë i shërbimeve janë relativisht më të zhvilluara, por ende ekziston nevojë për rritjen e transparencës, publikimin e listave të shërbimeve dhe dokumentimin më të mirë të standardeve dhe praktikave të ofrimit. Indikatorët e këtij dimensioni lidhen pikërisht me listën e shërbimeve, funksionin informues të QPS-së dhe standardet minimale.

Në kuadër të këtij dimensioni janë analizuar tre indikatorë:
1. ekzistenca dhe publikimi i listës së shërbimeve sociale;
2. funksionimi i Qendrës për Punë Sociale si qendër informacioni për qytetarët;
3. ekzistenca e listës dhe standardeve minimale të shërbimeve sociale.

Matrica e monitorimit i lidh këta indikatorë kryesisht me Drejtorinë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Qendrën për Punë Sociale, ndërsa për standardet minimale përgjegjësi i është atribuar edhe Kryetarit të Komunës.

Vlerësimi përfshin 28 komuna. Me tre indikatorë për secilën komunë, janë analizuar gjithsej 84 raste individuale.

Nga 84 rastet:
- 26 raste, ose 31.0%, janë të mbështetura me të dhëna primare;
- 26 raste, ose 31.0%, janë të mbështetura me të dhëna sekondare;
- 32 raste, ose 38.1%, rezultojnë pa përmbushje.

Në total, duke marrë së bashku të dhënat primare dhe sekondare, 52 nga 84 raste, ose 61.9%, rezultojnë me përmbushje.

Rezultatet tregojnë se niveli i përgjithshëm i përmbushjes është mbi 60%, por struktura e evidencës paraqet një karakteristikë të rëndësishme: numri i rasteve të mbështetura me të dhëna primare dhe sekondare është identik – nga 26 raste secila.

Kjo tregon se, edhe pse në një pjesë të konsiderueshme të komunave është konstatuar përmbushja, vetëm gjysma e rasteve të përmbushura mbështeten me dokumentacion primar institucional.

Në aspektin krahasues, performanca më e lartë është evidentuar te informimi i qytetarëve përmes QPS-së, ndërsa niveli më i ulët është evidentuar te publikimi i listës së shërbimeve sociale.

3.1. Përmbushja sipas indikatorëve dhe përgjegjësive institucionale

3.1.1. Lista e shërbimeve sociale

Indikatori vlerëson nëse ekziston dhe është publike lista e shërbimeve sociale në dispozicion të qytetarëve.

Nga 28 komunat:
- 8 komuna – 28.6% kanë të dhëna primare;
- 8 komuna – 28.6% kanë të dhëna sekondare;
- 12 komuna – 42.9% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, 16 nga 28 komuna, ose 57.1%, rezultojnë me përmbushje të indikatorit.

Rezultati tregon se vetëm pak më shumë se gjysma e komunave kanë dëshmi për ekzistencën e listës së shërbimeve sociale.

Veçanërisht me rëndësi është fakti se vetëm tetë komuna kanë të dhëna primare, ndërsa në tetë raste të tjera përmbushja rezulton vetëm nga të dhënat sekondare.

Publikimi i listës së shërbimeve nuk duhet të shihet vetëm si çështje administrative. Ai lidhet drejtpërdrejt me qasjen e qytetarëve në shërbime, pasi qytetarët duhet të kenë informacion të qartë për llojet e shërbimeve që ofrohen, institucionin përgjegjës dhe mënyrën e përfitimit të tyre.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë për këtë indikator lidhen me:
- Drejtorinë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- Qendrën për Punë Sociale.

Për secilin prej këtyre institucioneve, nga 28 raste të mundshme:
- 8 raste – 28.6% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar dhe të mbështetur me evidencë primare;
- 8 raste – 28.6% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 12 raste – 42.9% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, si për DSHMS-në ashtu edhe për QPS-në, përgjegjësia e lidhur me këtë indikator rezulton e përmbushur në 16 nga 28 raste, ose 57.1%.

3.1.2. Informimi i qytetarëve

Indikatori vlerëson nëse Qendra për Punë Sociale shërben si qendër informacioni për qytetarët lidhur me shërbimet sociale.

Nga 28 komunat:
- 10 komuna – 35.7% kanë të dhëna primare;
- 9 komuna – 32.1% kanë të dhëna sekondare;
- 9 komuna – 32.1% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, 19 nga 28 komuna, ose 67.9%, rezultojnë me përmbushje.

Ky është indikatori me nivelin më të lartë të përmbushjes në Dimensionin 3.

Megjithatë, dallimi ndërmjet evidencës primare dhe sekondare është i vogël: dhjetë raste mbështeten me të dhëna primare dhe nëntë me të dhëna sekondare.

Kjo tregon se në një numër relativisht të madh komunash funksioni informues i QPS-së është identifikuar, por nuk shoqërohet domosdoshmërisht me dokumentacion institucional që e dëshmon në mënyrë të drejtpërdrejtë këtë funksion.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësia për këtë indikator lidhet drejtpërdrejt me:
- Qendrën për Punë Sociale.

Nga 28 raste të mundshme:
- 10 raste – 35.7% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar dhe të mbështetur me evidencë primare;
- 9 raste – 32.1% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 9 raste – 32.1% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia e QPS-së e lidhur me këtë indikator rezulton e përmbushur në 19 nga 28 raste, ose 67.9%.

Ky është një rezultat relativisht pozitiv, por struktura e evidencës tregon nevojën për formalizim dhe dokumentim më të mirë të funksionit informues të QPS-ve.

3.1.3. Standardet minimale të shërbimeve sociale

Indikatori vlerëson nëse ekzistojnë lista dhe standardet përkatëse mbi bazën e të cilave ofrohen shërbimet sociale.

Nga 28 komunat:
- 8 komuna – 28.6% kanë të dhëna primare;
- 9 komuna – 32.1% kanë të dhëna sekondare;
- 11 komuna – 39.3% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, 17 nga 28 komuna, ose 60.7%, rezultojnë me përmbushje.

Rezultati është më i lartë se ai për publikimin e listës së shërbimeve sociale, por niveli i evidencës primare mbetet i ulët.

Vetëm në tetë komuna përmbushja është mbështetur me të dhëna primare, ndërsa në nëntë raste të tjera është konstatuar përmes të dhënave sekondare.

Standardet janë të rëndësishme sepse krijojnë bazën për vlerësimin e:
- cilësisë së shërbimeve;
- kushteve të ofrimit;
- përgjegjësive të ofruesve;
- trajtimit të barabartë të përfituesve;
- monitorimit të cilësisë dhe rezultateve.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë për këtë indikator lidhen me:
- Kryetarin e Komunës;
- Drejtorinë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- Qendrën për Punë Sociale.

Për secilin prej këtyre institucioneve:
- 8 raste – 28.6% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar dhe të mbështetur me evidencë primare;
- 9 raste – 32.1% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 11 raste – 39.3% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia e lidhur me këtë indikator rezulton e përmbushur në 17 nga 28 raste, ose 60.7%, për secilin nga institucionet përgjegjëse.

Tabela 5 - Përmbledhje e përgjegjësive institucionale

Në nivel të Dimensionit 3, përgjegjësitë kryesore janë të shpërndara ndërmjet Kryetarit të Komunës, DSHMS-së dhe QPS-së.

Institucioni përgjegjës	Raste të mundshme	Me evidencë primare	Sipas të dhënave sekondare	Pa përmbushje	Gjithsej të përmbushura
Kryetari i Komunës	28	8 (28.6%)	9 (32.1%)	11 (39.3%)	17 (60.7%)
DSHMS	56	16 (28.6%)	17 (30.4%)	23 (41.1%)	33 (58.9%)
QPS	84	26 (31.0%)	26 (31.0%)	32 (38.1%)	52 (61.9%)

Qendra për Punë Sociale ka përgjegjësinë më të gjerë në këtë dimension, pasi është e lidhur me të tre indikatorët. Nga 84 raste të mundshme, 52 ose 61.9% rezultojnë të përmbushura.

Një karakteristikë e rëndësishme e QPS-së është shpërndarja identike ndërmjet evidencës primare dhe sekondare: 26 raste primare dhe 26 raste sekondare. DSHMS-ja lidhet me dy indikatorë dhe rezulton me 58.9% përmbushje, ndërsa 41.1% e rasteve rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme.

Kryetari i Komunës lidhet vetëm me indikatorin e standardeve minimale dhe rezulton me 60.7% përmbushje. Ky rezultat, për këtë arsye, nuk duhet të krahasohet drejtpërdrejt me institucionet që kanë përgjegjësi në dy ose tre indikatorë.

Tabela 6 – përmbledhja e përmbushjes sipas indikatorit 3

Rangu	Komuna	Lista e shërbimeve sociale	Informimi i qytetarëv	Standardet minimale	Primare	Sekondare	Pa përmbushje	Gjithsej të përmbushura	Përmbushja
1	Lipjan	1	1	1	3	0	0	3/3	100%
1	Prishtinë	1	1	1	3	0	0	3/3	100%
1	Suharekë	1	1	1	3	0	0	3/3	100%
1	Junik	1	1	1	3	0	0	3/3	100%
1	Graçanicë	1	1	1	3	0	0	3/3	100%
2	Hani i Elezit	1	1	2	2	1	0	3/3	100%
3	Dragash	1	0	1	2	0	1	2/3	66,70%
3	Rahovec	1	1	0	2	0	1	2/3	66,70%
3	Shtime	0	1	1	2	0	1	2/3	66,70%
4	Istog	0	1	2	1	1	1	2/3	66,70%
5	Podujevë	0	0	1	1	0	2	1/3	33,30%
5	Prizren	0	1	0	1	0	2	1/3	33,30%
6	Gllogoc	2	2	2	0	3	0	3/3	100%
6	Klinë	2	2	2	0	3	0	3/3	100%
6	Skënderaj	2	2	2	0	3	0	3/3	100%
6	Mitrovicë e Jugut	2	2	2	0	3	0	3/3	100%
7	Fushë Kosovë	0	2	2	0	2	1	2/3	66,70%
7	Kamenicë	2	2	0	0	2	1	2/3	66,70%
7	Obiliq	2	0	2	0	2	1	2/3	66,70%
7	Pejë	2	0	2	0	2	1	2/3	66,70%
8	Ferizaj	0	2	0	0	1	2	1/3	33,30%
8	Viti	2	0	0	0	1	2	1/3	33,30%

8	Mitrovicë e Veriut	0	2	0	0	1	2	1/3	33,30%
8	Mamushë	0	2	0	0	1	2	1/3	33,30%
9	Gjakovë	0	0	0	0	0	3	0/3	0%
9	Gjilan	0	0	0	0	0	3	0/3	0%
9	Vushtrri	0	0	0	0	0	3	0/3	0%
9	Ranillug	0	0	0	0	0	3	0/3	0%

Në krye të renditjes janë Lipjani, Prishtina, Suhareka, Juniku dhe Graçanica, të cilat kanë evidencë primare për të tre indikatorët dhe përmbushje prej 100%.

Hani i Elezit ka po ashtu përmbushje të plotë, me dy indikatorë të mbështetur me të dhëna primare dhe një me të dhëna sekondare.

Gllogoci, Klina, Skënderaj dhe Mitrovica e Jugut kanë gjithashtu përmbushje 100%, por të tre indikatorët mbështeten me të dhëna sekondare. Për këtë arsye renditen pas komunave me evidencë primare.

Një grup tjetër përbëhet nga Dragashi, Rahoveci, Shtimja, Istogu, Fushë Kosova, Kamenica, Obiliqi dhe Peja, të cilat rezultojnë me përmbushje në dy nga tre indikatorët, por ndryshojnë dukshëm për nga fuqia e evidencës.

Në fund të renditjes janë Gjakova, Gjilani, Vushtrria dhe Ranillugu, ku nuk është konstatuar përmbushje e verifikueshme në asnjërin prej tre indikatorëve.

Shënim metodologjik

Renditja duhet të interpretohet duke dalluar ndërmjet nivelit të përmbushjes dhe fuqisë së evidencës.

Një komunë mund të ketë përmbushje 100%, por nëse të gjitha rastet janë të mbështetura vetëm me të dhëna sekondare, ajo renditet pas një komune që ka numër më të madh të indikatorëve të dëshmuar me evidencë primare.

DIMENSIONI 4: SHËRBIMET SPECIFIKE PËR FËMIJË

4. Përmbledhje e përgjithshme

Dimensioni "Shërbimet specifike për fëmijë" vlerëson nivelin në të cilin komunat sigurojnë ose mbështesin forma konkrete dhe të specializuara të shërbimeve sociale për fëmijët, përfshirë shërbimet rezidenciale, kujdesin ditor, shërbimet në shtëpi dhe format e kujdesit me bazë në komunitet.

Në Dimensionin 4 janë vlerësuar gjithsej 112 raste, të ndara në katër indikatorë për 28 komuna. Nga këto, vetëm 16 raste janë mbështetur me të dhëna primare (14.3%), 17 raste me të dhëna sekondare (15.2%), ndërsa 79 raste, ose 70.5%, kanë rezultuar pa përmbushje të verifikueshme. Në total, vetëm 33 nga 112 raste, ose 29.5%, rezultojnë të përmbushura.

Ky është dimensioni me nivelin më të ulët të përmbushjes në të gjithë monitorimin.

Rezultati më i mirë paraqitet te shërbimet në shtëpi për fëmijët me nevoja të veçanta, ku 16 nga 28 komunat, ose 57.1%, rezultojnë me përmbushje. Prej tyre, 7 raste janë të mbështetura me evidencë primare dhe 9 me të dhëna sekondare.

Në anën tjetër, qendrat e kujdesit ditor paraqesin rezultatin më të ulët, me vetëm 17.9% përmbushje, përkatësisht 5 nga 28 komuna. Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve ose kontratat përkatëse dhe shtëpitë me bazë në komunitet kanë secila nga 21.4% përmbushje. Struktura e indikatorëve të këtij dimensioni përfshin pikërisht këto katër forma të shërbimit.

Rezultati tregon një boshllëk të theksuar në infrastrukturën dhe ofertën e shërbimeve të specializuara për fëmijë. Përderisa mekanizmat institucionalë dhe format bazë të informimit ekzistojnë në një numër relativisht më të madh komunash, shërbimet që kërkojnë staf të specializuar, kapacitete të dedikuara dhe financim të vazhdueshëm janë shumë më pak të zhvilluara.

Në përgjithësi, Dimensioni 4 përfaqëson hallkën më të dobët të sistemit komunal dhe tregon se sfida kryesore është kalimi nga mekanizmat dhe planifikimi drejt ofrimit konkret të shërbimeve të specializuara.

Në kuadër të këtij dimensioni janë analizuar katër indikatorë:

1. shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve ose kontraktimi i këtyre shërbimeve;
2. ekzistenca e qendrave për kujdes ditor;
3. ofrimi i shërbimeve në shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe sëmundje të rënda kronike;
4. ekzistenca e shtëpive me bazë në komunitet.

Këto forma të shërbimeve mbështeten në dispozita të ndryshme ligjore: shërbimet rezidenciale dhe strehimoret për mbrojtjen e fëmijëve, qendrat e kujdesit ditor, shërbimet shtëpiake dhe format e kujdesit me bazë në komunitet.

Vlerësimi përfshin 28 komuna. Me katër indikatorë për secilën komunë, janë analizuar gjithsej 112 raste individuale.

Nga këto:

- 16 raste, ose 14.3%, janë të mbështetura me të dhëna primare;
- 17 raste, ose 15.2%, janë të mbështetura me të dhëna sekondare;
- 79 raste, ose 70.5%, rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme.

Në total, duke marrë së bashku të dhënat primare dhe sekondare, vetëm 33 nga 112 raste, ose 29.5%, rezultojnë me përmbushje.

Ky është një nivel dukshëm më i ulët krahasuar me tri dimensionet paraprake. Më shumë se shtatë në dhjetë raste rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme.

Rezultatet tregojnë se sfida kryesore nuk lidhet më vetëm me krijimin e mekanizmave, planifikimin apo informimin, por me disponueshmërinë reale të shërbimeve të specializuara për fëmijët në nivel lokal.

Dallimet ndërmjet indikatorëve janë të mëdha. Shërbimet në shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe sëmundje të rënda kronike paraqesin nivelin më të lartë të përmbushjes, ndërsa qendrat për kujdes ditor kanë rezultatin më të ulët.

4.1. Përmbushja sipas indikatorëve dhe përgjegjësive institucionale

4.1.1. Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve

Indikatori vlerëson nëse komuna menaxhon shtëpi për mbrojtjen e fëmijëve ose ka kontrata për sigurimin e këtij shërbimi.

Matrica e monitorimit e lidh këtë indikator me shërbimet rezidenciale për mbrojtjen e fëmijëve.

Nga 28 komunat:

- 3 komuna – 10.7% kanë të dhëna primare;
- 3 komuna – 10.7% kanë të dhëna sekondare;
- 22 komuna – 78.6% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, vetëm 6 nga 28 komuna, ose 21.4%, rezultojnë me përmbushje.

Ky rezultat tregon se shërbimet rezidenciale ose marrëveshjet për sigurimin e tyre janë shumë pak të përhapura në nivel komunal.

Veçanërisht domethënës është fakti se gati katër në pesë komuna rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë e lidhura me këtë indikator i atribuohen:

- Kryetarit të Komunës;
- Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- Qendrës për Punë Sociale.

Për secilin nga këta aktorë institucionalë:

- 3 raste – 10.7% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar dhe të mbështetur me evidencë primare;
- 3 raste – 10.7% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 22 raste – 78.6% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia e lidhur me këtë indikator rezulton e përmbushur vetëm në 6 nga 28 raste, ose 21.4%.

4.1.2. Qendrat për Kujdes Ditor

Indikatori vlerëson nëse në komunë ekzistojnë qendra ditore për ofrimin e shërbimeve për fëmijët. Baza metodologjike e lidh këtë indikator me qendrat e kujdesit ditor të parashikuara në kuadër të shërbimeve sociale dhe familjare.

Nga 28 komunat:

- 3 komuna – 10.7% kanë të dhëna primare;
- 2 komuna – 7.1% kanë të dhëna sekondare;
- o3 komuna – 82.1% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, vetëm 5 nga 28 komuna, ose 17.9%, rezultojnë me përmbushje.

Ky është indikatori me nivelin më të ulët të përmbushjes në Dimensionin 4.

Mbi 82% e komunave rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme, ndërsa vetëm tri komuna kanë evidencë primare për ekzistencën e qendrave të kujdesit ditor.

Rezultati tregon se kjo formë e shërbimit mbetet shumë e kufizuar në nivel lokal.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë lidhen me:
- Kryetarin e Komunës;
- DSHMS-në;
- QPS-në.

Për secilin institucion:
- 3 raste – 10.7% janë të mbështetura me evidencë primare;
- 2 raste – 7.1% janë të konstatuara sipas të dhënave sekondare;
- 23 raste – 82.1% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia rezulton e përmbushur në vetëm 5 nga 28 raste, ose 17.9%.

Ky është njëkohësisht niveli më i ulët i përmbushjes së përgjegjësive institucionale brenda këtij dimensioni.

4.1.3. Shërbimet në shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe sëmundje të rënda kronike;

Indikatori vlerëson nëse ofrohen shërbime në shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe sëmundje të rënda kronike.

Kjo formë shërbimi lidhet me dispozitat për shërbimet shtëpiake për personat dhe fëmijët aftësi të kufizuara dhe sëmundje të rënda kronike.

Nga 28 komunat:
- 7 komuna – 25.0% kanë të dhëna primare;
- 9 komuna – 32.1% kanë të dhëna sekondare;
- 12 komuna – 42.9% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, 16 nga 28 komuna, ose 57.1%, rezultojnë me përmbushje.

Ky është indikatori me nivelin më të lartë të përmbushjes në Dimensionin 4.

Megjithatë, struktura e evidencës tregon se të dhënat sekondare janë më të shumta se ato primare. Nga 16 raste të përmbushura, nëntë mbështeten në të dhëna sekondare dhe vetëm shtatë në evidencë primare.

Kjo tregon se shërbimet në shtëpi janë forma më e përhapur e shërbimit specifik të analizuar, por dokumentimi institucional i tyre mbetet i kufizuar.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë lidhen me:
oKryetarin e Komunës;
oDSHMS-në;
oQPS-në.

Për secilin institucion:
- 7 raste – 25.0% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar me evidencë primare;
- 9 raste – 32.1% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 12 raste – 42.9% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia e lidhur me indikatorin rezulton e përmbushur në 16 nga 28 raste, ose 57.1%.

Ky rezultat është dukshëm më i lartë se në tre indikatorët e tjerë të dimensionit.

4.1.4. Shtëpitë me bazë në komunitet

Indikatori vlerëson nëse komuna ka shtëpi me bazë në komunitet.

Këto shërbime janë pjesë e formave alternative të kujdesit social dhe të shërbimeve me bazë në komunitet.

Nga 28 komunat:
- 3 komuna – 10.7% kanë të dhëna primare;
- 3 komuna – 10.7% kanë të dhëna sekondare;
- 22 komuna – 78.6% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, vetëm 6 nga 28 komuna, ose 21.4%, rezultojnë me përmbushje.

Rezultati është i njëjtë me indikatorin për shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve dhe tregon se format e kujdesit rezidencial ose me bazë në komunitet mbeten shumë të kufizuara në nivel komunal.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë lidhen me:
- Kryetarin e Komunës;
- DSHMS-në;
- QPS-në.

Për secilin institucion:
- 3 raste – 10.7% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar me evidencë primare;
- 3 raste – 10.7% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 22 raste – 78.6% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia rezulton e përmbushur vetëm në 6 nga 28 raste, ose 21.4%.

Tabela 7 - Përmbledhje e përgjegjësive institucionale

Në Dimensionin 4, të katër indikatorët lidhen me të njëjtët tre aktorë institucionalë:
- Kryetarin e Komunës;
- DSHMS-në;
- QPS-në.

Për këtë arsye, secili prej tyre ka 112 raste të mundshme përgjegjësie.

Institucioni përgjegjës	Raste të mundshme	Me evidencë primare	Sipas të dhënave sekondare	Pa përmbushje	Gjithsej të përmbushura
Kryetari i Komunës	112	16 (14.3%)	17 (15.2%)	79 (70.5%)	33 (29.5%)
DSHMS	112	16 (14.3%)	17 (15.2%)	79 (70.5%)	33 (29.5%)
QPS	112	16 (14.3%)	17 (15.2%)	79 (70.5%)	33 (29.5%)

Rezultati i përgjithshëm i përgjegjësive institucionale është dukshëm më i ulët se në dimensionet paraprake.

Vetëm 29.5% e përgjegjësive të lidhura me shërbimet specifike për fëmijë rezultojnë të përmbushura, ndërsa 70.5% rezultojnë pa përmbushje.

Gjithashtu, evidenca primare është vetëm 14.3%, çka tregon jo vetëm disponueshmëri të kufizuar të shërbimeve, por edhe nivel shumë të ulët të dokumentimit të tyre.

Tabela 8 – përmbledhja e përmbushjes sipas indikatorit 4

Rangimi	Komuna	Shtëpi për mbrojtjen e fëmijëve	Qendra për kujdes ditor	Shërbime në shtëpi	Shtëpi me bazë në komunitet	Primare	Sekondare	Pa përmbushje	Gjithsej të përmbushura	Përmbushja
1	Lipjan	1	1	1	1	4	0	0	4/4	100%
1	Prizren	1	1	1	1	4	0	0	4/4	100%
2	Istog	1	0	1	0	2	0	2	2/4	50%
2	Rahovec	0	1	1	0	2	0	2	2/4	50%
3	Shtime	2	0	1	1	2	1	1	3/4	75%
4	Suharekë	0	0	1	0	1	0	3	1/4	25%

4	Junik	0	0	1	0	1	0	3	1/4	25%
5	Dragash	2	0	2	2	0	3	1	3/4	75%
5	Graçanicë	0	2	2	2	0	3	1	3/4	75%
6	Pejë	0	2	2	0	0	2	2	2/4	50%
6	Skënderaj	2	0	2	0	0	2	2	2/4	50%
7	Gllogoc	0	0	2	0	0	1	3	1/4	25%
7	Fushë Kosovë	0	0	2	0	0	1	3	1/4	25%
7	Kamenicë	0	0	0	2	0	1	3	1/4	25%
7	Ferizaj	0	0	2	0	0	1	3	1/4	25%
7	Viti	0	0	2	0	0	1	3	1/4	25%
7	Hani i Elezit	0	0	2	0	0	1	3	1/4	25%
8	Gjakovë	0	0	0	0	0	0	4	0/4	0%
8	Gjilan	0	0	0	0	0	0	4	0/4	0%
8	Klinë	0	0	0	0	0	0	4	0/4	0%
8	Obiliq	0	0	0	0	0	0	4	0/4	0%
8	Podujevë	0	0	0	0	0	0	4	0/4	0%
8	Prishtinë	0	0	0	0	0	0	4	0/4	0%
8	Vushtrri	0	0	0	0	0	0	4	0/4	0%
8	Mitrovicë e Veriut	0	0	0	0	0	0	4	0/4	0%
8	Mitrovicë e Jugut	0	0	0	0	0	0	4	0/4	0%
8	Mamushë	0	0	0	0	0	0	4	0/4	0%
8	Ranillug	0	0	0	0	0	0	4	0/4	0%

Në krye të renditjes janë Lipjani dhe Prizreni, të cilat rezultojnë me evidencë primare për të katër indikatorët dhe përmbushje prej 100%.

Pas tyre, Shtimja paraqet një profil të rëndësishëm me tri nga katër shërbimet të identifikuara, prej të cilave dy mbështeten me të dhëna primare dhe një me të dhëna sekondare.

Dragashi dhe Graçanica rezultojnë gjithashtu me përmbushje në tri nga katër indikatorët, por të gjitha rastet mbështeten në të dhëna sekondare. Për këtë arsye, sipas metodologjisë së renditjes, pozicionohen pas komunave me evidencë primare.

Në anën tjetër, një numër i konsiderueshëm komunash — Gjakova, Gjilani, Klina, Obiliqi, Podujeva, Prishtina, Vushtrria, Mitrovica e Veriut, Mitrovica e Jugut, Mamusha dhe Ranillugu, rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme në të katër indikatorët.

Ky përqendrim i lartë i komunave me rezultat zero e dallon Dimensionin 4 nga dimensionet paraprake dhe tregon se disponueshmëria e shërbimeve specifike për fëmijë është një nga fushat më të dobëta të sistemit lokal të shërbimeve sociale.

DIMENSIONI 5: FINANCIMI

5. Përmbledhje e përgjithshme

Dimensioni "Financimi" vlerëson nivelin në të cilin komunat kanë siguruar dhe dokumentuar financimin e shërbimeve sociale dhe të formave specifike të kujdesit për fëmijët. Në Dimensionin 5 janë vlerësuar gjithsej 140 raste, të ndara në pesë indikatorë për 28 komuna. Nga këto, 30 raste janë mbështetur me të dhëna primare (21.4%), 24 raste me të dhëna sekondare (17.1%), ndërsa 86 raste, ose 61.4%, kanë rezultuar pa përmbushje të verifikueshme. Në total, vetëm 54 nga 140 raste, ose 38.6%, rezultojnë të përmbushura.

Rezultati më i lartë është evidentuar te mbështetja financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në përkujdesje familjare, me 60.7% përmbushje.

Indikatori për linjën buxhetore për shërbimet sociale rezulton me 53.6% përmbushje, çka tregon se pak më shumë se gjysma e komunave kanë mundur të dëshmojnë ose konfirmojnë ekzistimin e një baze të identifikueshme financiare për këtë fushë.

Rezultati bie ndjeshëm te financimi i shërbimeve më të specializuara. Shërbimet rezidenciale arrijnë vetëm 35.7%, ndërsa financimi i qendrave të kujdesit ditor dhe shtëpive me bazë në komunitet arrin vetëm 21.4% secila. Indikatorët e këtij dimensioni mbulojnë linjën buxhetore, mbështetjen financiare, strehimoret, qëndrimin ditor dhe shtëpitë me bazë në komunitet.

Ky rezultat është veçanërisht i rëndësishëm kur krahasohet me Dimensionin 4.

Shërbimet që paraqiten më pak të zhvilluara janë njëkohësisht edhe ato që financohen më pak. Kjo tregon se boshllëqet në shërbimet specifike nuk janë vetëm çështje organizimi institucional, por lidhen drejtpërdrejt me mungesën e financimit të qëndrueshëm.

Në përgjithësi, Dimensioni 5 tregon se financimi mbetet një nga kufizimet kryesore të sistemit. Pa lidhje më të fortë ndërmjet analizës së nevojave, planifikimit dhe ndarjeve buxhetore, zhvillimi i shërbimeve të reja dhe qëndrueshmëria e atyre ekzistuese mbeten të kufizuara.

Në kuadër të këtij dimensioni janë analizuar pesë indikatorë:
1. ekzistenca e linjës buxhetore për shërbime sociale;
2. mbështetja financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim;
3. financimi i shërbimeve rezidenciale dhe strehimoreve për fëmijë;
4. financimi i qendrave të kujdesit ditor;
5. financimi i shtëpive me bazë në komunitet.

Matrica e monitorimit i lidh të pesë indikatorët me Kryetarin e Komunës, Drejtorinë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.

Vlerësimi përfshin 28 komuna. Me pesë indikatorë për secilën komunë, janë analizuar gjithsej 140 raste individuale.

Nga këto:
- 30 raste, ose 21.4%, janë të mbështetura me të dhëna primare;
- 24 raste, ose 17.1%, janë të mbështetura me të dhëna sekondare;
- 86 raste, ose 61.4%, rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme.

Në total, duke marrë së bashku të dhënat primare dhe sekondare, 54 nga 140 raste, ose 38.6%, rezultojnë me përmbushje.

Rezultatet tregojnë se financimi është një nga dimensionet me nivel më të ulët të përmbushjes. Më shumë se gjashtë në dhjetë raste rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme, ndërsa vetëm rreth një në pesë raste mbështetet me evidencë primare.

Dallimet ndërmjet indikatorëve janë gjithashtu të konsiderueshme. Mbështetja financiare për familjet strehuese paraqet nivelin më të lartë të përmbushjes, ndërsa financimi i qendrave të kujdesit ditor dhe i shtëpive me bazë në komunitet paraqet nivelet më të ulëta.

Kjo tregon se sfida nuk qëndron vetëm te ekzistenca e shërbimeve, por te sigurimi i financimit të qëndrueshëm dhe të identifikueshëm për funksionimin e tyre.

5.1. Përmbushja sipas indikatorëve dhe përgjegjësive institucionale

5.1.1. Buxheti për shërbime sociale

Indikatori vlerëson nëse komuna ka linjë buxhetore për shërbime sociale.

Nga 28 komunat:
- 9 komuna – 32.1% kanë të dhëna primare;
- 6 komuna – 21.4% kanë të dhëna sekondare;
- 13 komuna – 46.4% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, 15 nga 28 komuna, ose 53.6%, rezultojnë me përmbushje të indikatorit.

Ky është një nga indikatorët me nivel më të lartë të përmbushjes në Dimensionin 5, por pothuajse gjysma e komunave rezultojnë pa linjë buxhetore të verifikueshme për shërbimet sociale.

Fakti që vetëm nëntë komuna kanë evidencë primare tregon se edhe aty ku financimi deklarohet, ai nuk është gjithmonë i identifikueshëm qartë përmes dokumenteve buxhetore.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë për këtë indikator lidhen me:
- Kryetarin e Komunës;
- DSHMS-në;
- Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.

Për secilin institucion:
- 9 raste – 32.1% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar me evidencë primare;
- 6 raste – 21.4% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 13 raste – 46.4% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia e lidhur me indikatorin rezulton e përmbushur në 15 nga 28 raste, ose 53.6%.

5.1.2. Familjet strehuese dhe fëmijët në strehim

Indikatori vlerëson nëse familjet strehuese dhe fëmijët në strehim mbështeten financiarisht.

Nga 28 komunat:
- 7 komuna – 25.0% kanë të dhëna primare;
- 10 komuna – 35.7% kanë të dhëna sekondare;
- 11 komuna – 39.3% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, 17 nga 28 komuna, ose 60.7%, rezultojnë me përmbushje.

Ky është indikatori me nivelin më të lartë të përmbushjes në Dimensionin 5. Megjithatë, struktura e evidencës tregon se të dhënat sekondare janë më të shumta se ato primare.

Vetëm shtatë komuna kanë evidencë primare, ndërsa në dhjetë raste mbështetja financiare është konstatuar përmes të dhënave sekondare.

Kjo tregon se mbështetja financiare për këtë kategori është relativisht më e përhapur, por nevojitet dokumentim më i qartë dhe më sistematik i saj.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë lidhen me:
- Kryetarin e Komunës;
- DSHMS-në;
- Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.

Për secilin institucion:
- 7 raste – 25.0% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar me evidencë primare;
- 10 raste – 35.7% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 11 raste – 39.3% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia rezulton e përmbushur në 17 nga 28 raste, ose 60.7%.

5.1.3. Financimi i shërbimeve rezidenciale

Indikatori vlerëson nëse financohen strehimoret ose format e tjera të shërbimeve rezidenciale për fëmijët.

Nga 28 komunat:
- 6 komuna – 21.4% kanë të dhëna primare;
- 4 komuna – 14.3% kanë të dhëna sekondare;
- 18 komuna – 64.3% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, vetëm 10 nga 28 komuna, ose 35.7%, rezultojnë me përmbushje.

Rezultati tregon se financimi i shërbimeve rezidenciale është dukshëm më i kufizuar sesa financimi i përgjithshëm i shërbimeve sociale apo mbështetja e familjeve strehuese.

Afro dy të tretat e komunave rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë lidhen me:
- Kryetarin e Komunës;
- DSHMS-në;
- Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.

Për secilin institucion:
- 6 raste – 21.4% janë të mbështetura me evidencë primare;
- 4 raste – 14.3% janë të konstatuara sipas të dhënave sekondare;
- 18 raste – 64.3% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia rezulton e përmbushur në 10 nga 28 raste, ose 35.7%.

5.1.4. Financimi i qendrave të kujdesit ditor

Indikatori vlerëson nëse komuna financon qëndrimin ditor dhe qendrat e kujdesit ditor për fëmijët.

Nga 28 komunat:
- 4 komuna – 14.3% kanë të dhëna primare;
- 2 komuna – 7.1% kanë të dhëna sekondare;
- 22 komuna – 78.6% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, vetëm 6 nga 28 komuna, ose 21.4%, rezultojnë me përmbushje.

Ky është një nga dy indikatorët me performancën më të ulët në Dimensionin 5.

Pothuajse katër në pesë komuna rezultojnë pa financim të verifikueshëm për këtë formë shërbimi.

Rezultati është veçanërisht i rëndësishëm kur krahasohet me Dimensionin 4, ku edhe ekzistenca e qendrave ditore rezultoi shumë e kufizuar. Kjo tregon se mungesa e shërbimit dhe mungesa e financimit janë të ndërlidhura.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë lidhen me:
- Kryetarin e Komunës;
- DSHMS-në;
- Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.

Për secilin:
- 4 raste – 14.3% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar me evidencë primare;
- 2 raste – 7.1% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 22 raste – 78.6% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia rezulton e përmbushur në 6 nga 28 raste, ose 21.4%.

2.5. Financimi i shtëpive me bazë në komunitet

Indikatori vlerëson nëse komuna financon shtëpitë me bazë në komunitet.

Nga 28 komunat:
- 4 komuna – 14.3% kanë të dhëna primare;
- 2 komuna – 7.1% kanë të dhëna sekondare;
- 22 komuna – 78.6% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, vetëm 6 nga 28 komuna, ose 21.4%, rezultojnë me përmbushje.

Rezultati është identik me financimin e qendrave të kujdesit ditor dhe tregon se format alternative të kujdesit social kanë nivel shumë të kufizuar të mbështetjes financiare komunale.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë lidhen me:
- Kryetarin e Komunës;
- DSHMS-në;
- Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.

Për secilin:
- 4 raste – 14.3% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar me evidencë primare;
- 2 raste – 7.1% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 22 raste – 78.6% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia rezulton e përmbushur vetëm në 6 nga 28 raste, ose 21.4%.

Tabela 9 - Përmbledhje e përgjegjësive institucionale

Në Dimensionin 5, të pesë indikatorët lidhen me të njëjtët tre aktorë institucionalë: Kryetarin e Komunës, DSHMS-në dhe Ekipin për të Drejtat e Fëmijës.

Për këtë arsye, secili aktor ka gjithsej 140 raste të mundshme përgjegjësie.

Institucioni përgjegjës	Raste të mundshme	Me evidencë primare	Sipas të dhënave sekondare	Pa përmbushje	Gjithsej të përmbushura
Kryetari i Komunës	140	30 (21.4%)	24 (17.1%)	86 (61.4%)	54 (38.6%)
DSHMS	140	30 (21.4%)	24 (17.1%)	86 (61.4%)	54 (38.6%)
Ekipi për të Drejtat e Fëmijës	140	30 (21.4%)	24 (17.1%)	86 (61.4%)	54 (38.6%)

Rezultatet tregojnë se vetëm 38.6% e përgjegjësive të lidhura me financimin rezultojnë të përmbushura, ndërsa 61.4% rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme.

Edhe më i ulët është niveli i evidencës primare, me vetëm 21.4% të rasteve.

Kjo tregon se dobësia e Dimensionit 5 nuk lidhet vetëm me dokumentimin, por edhe me nivelin e përgjithshëm të financimit të shërbimeve sociale dhe formave specifike të kujdesit.

Tabela 10 – përmbledhja e përmbushjes sipas indikatorit 5

Rangu	Komuna	Buxheti për	Familjet strehues	Shërbimet	Kujdesi ditor	Shtëpitë në	Primare	Sekondare	Pa përmbus	Përmbushja
1	Lipjan	1	1	1	1	1	5	0	0	100%
1	Prizren	1	1	1	1	1	5	0	0	100%
2	Prishtinë	1	1	1	0	0	3	0	2	60%
2	Shtime	1	1	1	0	0	3	0	2	60%
2	Graçanicë	1	0	0	1	1	3	0	2	60%
3	Pejë	1	0	1	2	0	2	1	2	60%
3	Junik	1	1	2	0	0	2	1	2	60%
4	Rahovec	1	0	0	1	0	2	0	3	40%
4	Suharekë	1	1	0	0	0	2	0	3	40%
4	Mamushë	0	1	1	0	0	2	0	3	40%
5	Klinë	0	0	0	0	1	1	0	4	20%
6	Ferizaj	0	2	2	2	2	0	4	1	80%
7	Kamenicë	2	2	0	0	2	0	3	2	60%
8	Dragash	0	2	2	0	0	0	2	3	40%
8	Istog	2	2	0	0	0	0	2	3	40%

8	Fushë Kosovë	0	2	2	0	0	0	2	3	40%
8	Obiliq	2	2	0	0	0	0	2	3	40%
8	Skënderaj	2	2	0	0	0	0	2	3	40%
9	Gllogoc	0	2	0	0	0	0	1	4	20%
9	Viti	0	2	0	0	0	0	1	4	20%
9	Mitrovicë e Veriut	2	0	0	0	0	0	1	4	20%
9	Mitrovicë e Jugut	2	0	0	0	0	0	1	4	20%
9	Hani i Elezit	0	2	0	0	0	0	1	4	20%
10	Gjakovë	0	0	0	0	0	0	0	5	0%
10	Gjilan	0	0	0	0	0	0	0	5	0%
10	Podujevë	0	0	0	0	0	0	0	5	0%
10	Vushtrri	0	0	0	0	0	0	0	5	0%
10	Ranillug	0	0	0	0	0	0	0	5	0%

Në krye të renditjes janë Lipjani dhe Prizreni, të cilat kanë evidencë primare për të pesë indikatorët dhe përmbushje prej 100%.

Pas tyre renditen Prishtina, Shtimja dhe Graçanica, me nga tri të dhëna primare. Peja dhe Juniku kanë nga dy të dhëna primare dhe një sekondare, ndërsa Rahoveci, Suhareka dhe Mamusha kanë nga dy raste të mbështetura me evidencë primare.

Një rast i veçantë është Ferizaj, i cili ka përmbushje në katër nga pesë indikatorët, pra 80%, por të gjitha rastet e përmbushura bazohen në të dhëna sekondare. Për këtë arsye renditet pas komunave që kanë evidencë primare.

Në fund të renditjes janë Gjakova, Gjilani, Podujeva, Vushtrria dhe Ranillugu, ku nuk është konstatuar përmbushje e verifikueshme në asnjërin prej pesë indikatorëve.

DIMENSIONI 6: KONTRAKTIMI DHE LICENCIMI

6. Përmbledhje e përgjithshme

Dimensioni "Kontraktimi dhe Licencimi" vlerëson nivelin në të cilin komunat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve sociale të jenë të licencuar, kontraktojnë shërbime kur është e nevojshme, i lidhin kontratat me planifikimin komunal, monitorojnë cilësinë e ofrimit dhe bashkëpunojnë me organizatat joqeveritare në ofrimin e shërbimeve sociale.

Në Dimensionin 6 janë vlerësuar gjithsej 140 raste, të ndara në pesë indikatorë për 28 komuna. Nga këto, 31 raste janë mbështetur me të dhëna primare (22.1%), 42 raste me të dhëna sekondare (30.0%), ndërsa 67 raste, ose 47.9%, kanë rezultuar pa përmbushje të verifikueshme. Në total, 73 nga 140 raste, ose 52.1%, rezultojnë të përmbushura.

Rezultati më i lartë është evidentuar te licencimi i ofruesve të shërbimeve, me 75% përmbushje, përkatësisht 21 nga 28 komuna. Megjithatë, vetëm 7 raste mbështeten me evidencë primare, ndërsa 14 me të dhëna sekondare. Kjo tregon se përmbushja është relativisht e lartë, por dokumentimi i saj mbetet i kufizuar.

Bashkëpunimi dhe financimi apo kontratat aktive me OJQ rezultojnë me 57.1% përmbushje.

Në anën tjetër, kontraktimi i shërbimeve sociale, përputhshmëria e kontratave me planin vjetor dhe monitorimi i cilësisë së ofruesve kanë secili nga 42.9% përmbushje. Këto janë edhe elementet kryesore të këtij dimensioni, së bashku me licencimin dhe bashkëpunimin me OJQ.

Gjetja më problematike lidhet me monitorimin e cilësisë, ku nuk është evidentuar asnjë rast i mbështetur me evidencë primare. Përmbushja e deklaruar për këtë indikator mbështetet vetëm në të dhëna sekondare.

Kjo tregon një dallim të rëndësishëm ndërmjet ekzistimit të marrëdhënies kontraktuese dhe menaxhimit të saj cilësor. Komunat duket se janë më të avancuara në identifikimin ose angazhimin e ofruesve të licencuar sesa në dokumentimin e kontraktimit, lidhjen e kontratave me planifikimin dhe monitorimin sistematik të cilësisë.

Në përgjithësi, Dimensioni 6 paraqet një nivel mesatar të përmbushjes, por me varësi të lartë nga të dhënat sekondare. Fokusi në të ardhmen duhet të zhvendoset nga ekzistenca formale e licencimit dhe kontraktimit drejt një sistemi ku shërbimet e kontraktuara lidhen me planet, standardet dhe indikatorët e performancës dhe monitorohen përmes evidencës së dokumentuar.

Në kuadër të këtij dimensioni janë analizuar pesë indikatorë:
1. licencimi i ofruesve të shërbimeve sociale;
2. kontraktimi i shërbimeve sociale nga komuna;
3. përputhshmëria e kontratave me planin vjetor;
4. monitorimi i cilësisë së ofruesve;
5. bashkëpunimi me OJQ-të përmes financimit ose kontratave aktive.

Matrica e monitorimit përcakton përgjegjësi të ndryshme sipas indikatorit. Licencimi lidhet me DSHMS-në dhe QPS-në, ndërsa katër indikatorët e tjerë lidhen me Kryetarin e Komunës, DSHMS-në, QPS-në dhe Drejtorinë e Financave.

Vlerësimi përfshin 28 komuna. Me pesë indikatorë për secilën komunë, janë analizuar gjithsej 140 raste individuale.

Nga këto:
- 31 raste, ose 22.1%, janë të mbështetura me të dhëna primare;
- 42 raste, ose 30.0%, janë të mbështetura me të dhëna sekondare;
- 67 raste, ose 47.9%, rezultojnë pa përmbushje të verifikueshme.

Në total, duke marrë së bashku të dhënat primare dhe sekondare, 73 nga 140 raste, ose 52.1%, rezultojnë me përmbushje.

Një karakteristikë e rëndësishme e këtij dimensioni është se të dhënat sekondare janë më të shumta se ato primare. Kjo tregon se në shumë raste komunat deklarojnë ose konfirmojnë ekzistencën e praktikave të kontraktimit, licencimit apo monitorimit, por nuk sigurojnë dokumentacion të mjaftueshëm primar për verifikimin e tyre.

Performanca ndryshon ndjeshëm ndërmjet indikatorëve. Licencimi i ofruesve paraqet nivelin më të lartë të përmbushjes, ndërsa kontraktimi, përputhshmëria me planin dhe monitorimi i cilësisë kanë nivel dukshëm më të ulët.

6.1. Përmbushja sipas indikatorëve dhe përgjegjësive institucionale

6.1.1. Licencimi i ofruesve të shërbimeve

Indikatori vlerëson nëse ofruesit e shërbimeve sociale janë të licencuar.

Nga 28 komunat:
- 7 komuna – 25.0% kanë të dhëna primare;
- 14 komuna – 50.0% kanë të dhëna sekondare;
- 7 komuna – 25.0% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, 21 nga 28 komuna, ose 75.0%, rezultojnë me përmbushje të indikatorit.

Ky është indikatori me nivelin më të lartë të përmbushjes në Dimensionin 6.

Megjithatë, struktura e evidencës është e rëndësishme: dy të tretat e rasteve të përmbushura bazohen në të dhëna sekondare. Vetëm shtatë komuna kanë evidencë primare, ndërsa 14 raste mbështeten në deklarime ose burime të tjera sekondare.

Kjo tregon se licencimi është relativisht i përhapur, por dokumentacioni që e dëshmon statusin e licencimit nuk është gjithmonë i disponueshëm ose i administruar në mënyrë sistematike në nivel komunal.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë për këtë indikator lidhen me:
- Drejtorinë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- Qendrën për Punë Sociale.

Për secilin prej këtyre institucioneve:
- 7 raste – 25.0% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar me evidencë primare;
- 14 raste – 50.0% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 7 raste – 25.0% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia rezulton e përmbushur në 21 nga 28 raste, ose 75.0%.

6.1.2. Kontraktimi i shërbimeve sociale

Indikatori vlerëson nëse komuna kontrakton ofrues të jashtëm për ofrimin e shërbimeve sociale.

Nga 28 komunat:
- 7 komuna – 25.0% kanë të dhëna primare;
- 5 komuna – 17.9% kanë të dhëna sekondare;
- 16 komuna – 57.1% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, 12 nga 28 komuna, ose 42.9%, rezultojnë me përmbushje.

Rezultati tregon se kontraktimi i shërbimeve sociale nuk është ende praktikë e konsoliduar në shumicën e komunave.

Në më shumë se gjysmën e komunave nuk është konstatuar përmbushje e verifikueshme, ndërsa vetëm shtatë komuna kanë dokumentacion primar për kontraktimin.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë lidhen me:
- Kryetarin e Komunës;
- DSHMS-në;
- QPS-në;
- Drejtorinë e Financave.

Për secilin institucion:
- 7 raste – 25.0% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar me evidencë primare;
- 5 raste – 17.9% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 16 raste – 57.1% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia e lidhur me këtë indikator rezulton e përmbushur në 12 nga 28 raste, ose 42.9%.

6.1.3. Përputhshmëria e kontratave me planin vjetor

Indikatori vlerëson nëse kontratat për shërbime sociale lidhen me planin vjetor dhe prioritetet e përcaktuara nga komuna.

Nga 28 komunat:
- 8 komuna – 28.6% kanë të dhëna primare;
- 4 komuna – 14.3% kanë të dhëna sekondare;
- 16 komuna – 57.1% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, 12 nga 28 komuna, ose 42.9%, rezultojnë me përmbushje.

Ky rezultat është i njëjtë me nivelin e kontraktimit, por ka strukturë pak më të fortë të evidencës primare.

Vetëm në rreth katër nga dhjetë komuna rezulton se kontraktimi është i lidhur me planifikimin vjetor. Kjo tregon se sfida nuk është vetëm ekzistenca e kontratave, por edhe lidhja sistematike e tyre me prioritetet dhe nevojat e identifikuara përmes planifikimit komunal.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë lidhen me:
- Kryetarin e Komunës;
- DSHMS-në;
- QPS-në;
- Drejtorinë e Financave.

Për secilin institucion:
- 0 raste – 0.0% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar me evidencë primare;
- 12 raste – 42.9% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 16 raste – 57.1% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia rezulton e përmbushur në 12 nga 28 raste, ose 42.9%, por në asnjë rast nuk është mbështetur me evidencë primare.

Ky është një sinjal i qartë se dokumentimi i monitorimit të cilësisë duhet të jetë një nga prioritetet kryesore për përmirësim.

6.1.5. Bashkëpunimi me OJQ-të

Indikatori vlerëson nëse komuna ka plan për financimin ose kontrata aktive me organizata joqeveritare për ofrimin e shërbimeve sociale.

Nga 28 komunat:
- 9 komuna – 32.1% kanë të dhëna primare;
- 7 komuna – 25.0% kanë të dhëna sekondare;
- 12 komuna – 42.9% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, 16 nga 28 komuna, ose 57.1%, rezultojnë me përmbushje.

Ky është indikatori i dytë me nivelin më të lartë të përmbushjes, pas licencimit.

Rezultati tregon se bashkëpunimi me OJQ-të është relativisht më i zhvilluar sesa kontraktimi formal i shërbimeve. Megjithatë, në 12 komuna nuk është konstatuar përmbushje e verifikueshme.

Përmbushja sipas përgjegjësive

Përgjegjësitë lidhen me:
- Kryetarin e Komunës;
- DSHMS-në;
- QPS-në;
- Drejtorinë e Financave.

Për secilin institucion:
- 9 raste – 32.1% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar me evidencë primare;
- 7 raste – 25.0% rezultojnë me përgjegjësi të zbatuar sipas të dhënave sekondare;
- 12 raste – 42.9% rezultojnë pa përmbushje.

Në total, përgjegjësia rezulton e përmbushur në 16 nga 28 raste, ose 57.1%.

Tabela 11 - Përmbledhje e përgjegjësive institucionale

Në Dimensionin 6, përgjegjësitë nuk janë të shpërndara njësoj ndërmjet institucioneve.
DSHMS-ja dhe QPS-ja lidhen me të pesë indikatorët, ndërsa Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave lidhen me katër indikatorë.

Institucioni përgjegjës	Raste të mundshme	Me evidencë primare	Sipas të dhënave sekondare	Pa përmbushje	Gjithsej të përmbushura
Kryetari i Komunës	112	24 (21.4%)	28 (25.0%)	60 (53.6%)	52 (46.4%)
DSHMS	140	31 (22.1%)	42 (30.0%)	67 (47.9%)	73 (52.1%)
QPS	140	31 (22.1%)	42 (30.0%)	67 (47.9%)	73 (52.1%)
Drejtoria e Financave	112	24 (21.4%)	28 (25.0%)	60 (53.6%)	52 (46.4%)

DSHMS-ja dhe QPS-ja kanë nivel të përgjithshëm të përmbushjes prej 52.1%, por vetëm 22.1% e rasteve të tyre mbështeten me evidencë primare. Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave kanë përmbushje prej 46.4%, ndërsa në më shumë se gjysmën e rasteve nuk është konstatuar përmbushje.

Një karakteristikë e përbashkët për të gjitha institucionet është pesha e lartë e të dhënave sekondare. Kjo është veçanërisht e lidhur me indikatorin e monitorimit të cilësisë, ku asnjë institucion nuk ka evidencë primare.

Tabela 12 – përmbledhja e përmbushjes sipas indikatorit 6

Rangimi	Komuna	Licencimi	Kontraktimi	Përputshmëria me	Monitorimi i cilësisë	Bashkëpunimi me OJQ	Primare	Sekondare	Pa përmbushje	Përmbushja
1	Lipjan	1	1	1	2	1	4	1	0	100%
1	Graçanicë	1	1	1	2	1	4	1	0	100%
2	Suharekë	1	1	1	0	1	4	0	1	80%
2	Mitrovicë e Jugut	1	1	1	0	1	4	0	1	80%
3	Istog	1	1	1	2	0	3	1	1	80%
4	Prizren	1	1	1	0	0	3	0	2	60%
5	Hani i Elezit	2	1	1	2	0	2	2	1	80%
6	Klinë	1	1	0	0	0	2	0	3	40%
7	Prishtinë	1	2	0	2	1	1	3	1	80%

8	Rahovec	1	0	0	2	0	1	1	3	40%
8	Junik	1	0	0	2	0	1	1	3	40%
8	Mamushë	1	0	0	2	0	1	1	3	40%
9	Shtime	1	0	0	0	0	1	0	4	20%
10	Obiliq	2	2	2	2	2	0	5	0	100%
10	Pejë	2	2	2	2	2	0	5	0	100%
10	Ferizaj	2	2	2	2	2	0	5	0	100%
11	Gllogoc	2	2	2	2	0	0	4	1	80%
11	Fushë Kosovë	2	2	2	2	0	0	4	1	80%
12	Dragash	2	2	0	0	0	0	2	3	40%
12	Podujevë	2	2	0	0	0	0	2	3	40%
13	Kamenicë	2	0	0	0	0	0	1	4	20%
13	Skënderaj	2	0	0	0	0	0	1	4	20%
13	Viti	2	0	0	0	0	0	1	4	20%
13	Mitrovicë e Veriut	2	0	0	0	0	0	1	4	20%
14	Gjakovë	0	0	0	0	0	0	0	5	0%
14	Gjilan	0	0	0	0	0	0	0	5	0%
14	Vushtrri	0	0	0	0	0	0	0	5	0%
14	Ranillug	0	0	0	0	0	0	0	5	0%

Në krye të renditjes janë Lipjani dhe Graçanica, me katër indikatorë të mbështetur me evidencë primare dhe një me evidencë sekondare, duke arritur përmbushje prej 100%.

Suhareka dhe Mitrovica e Jugut kanë nga katër raste me evidencë primare dhe një rast pa përmbushje, ndërsa Istogu ka tri primare, një sekondare dhe një rast pa përmbushje.

Një profil i veçantë paraqesin Obiliqi, Peja dhe Ferizaj. Të tri komunat kanë përmbushje në të pesë indikatorët, pra 100%, por të gjitha rastet mbështeten me të dhëna sekondare. Kjo i vendos ato më poshtë në renditjen sipas fuqisë së evidencës.

Në fund të renditjes janë Gjakova, Gjilani, Vushtrria dhe Ranillugu, ku nuk është konstatuar përmbushje e verifikueshme në asnjërin prej pesë indikatorëve.

INTERPRETIMI I REZULTATEVE TË PËRMBLEDHURA

Për interpretimin e rezultateve është përdorur kjo shkallë:

Pikët totale nga 25	Përqindja	Kategoria	Ngjyra
20.0–25.0	80–100%	Nivel shumë i lartë	🟢
15.0–19.9	60–79.9%	Nivel i lartë	🟩
10.0–14.9	40–59.9%	Nivel mesatar	🟡
5.0–9.9	20–39.9%	Nivel i ulët	🟠
0–4.9	0–19.9%	Nivel shumë i ulët	🔴

Renditja bëhet sipas numrit total të pikëve të ponderuara. Në rast se dy ose më shumë komuna kanë rezultat të njëjtë, përparësi i jepet komunës që ka numër më të madh të evidencave primare, pasi ato përfaqësojnë nivel më të lartë të verifikueshmërisë së përmbushjes.

Tabela 13 – rezultatet e përmbledhura sipas Komunave

Rangimi	Komuna	Primare	Sekondare	Total pikë	Rezultati	Kategoria
1	Lipjan	23	2	24.0 / 25	96%	🟢 Nivel shumë i lartë
2	Prizren	19	0	19.0 / 25	76%	🟩 Nivel i lartë
3	Suharekë	18	0	18.0 / 25	72%	🟩 Nivel i lartë
4	Shtime	13	2	14.0 / 25	56%	🟡 Nivel mesatar
5	Junik	11	6	14.0 / 25	56%	🟡 Nivel mesatar
6	Hani i Elezit	11	5	13.5 / 25	54%	🟡 Nivel mesatar
7	Rahovec	12	2	13.0 / 25	52%	🟡 Nivel mesatar
8	Istog	11	4	13.0 / 25	52%	🟡 Nivel mesatar
9	Graçanicë	11	4	13.0 / 25	52%	🟡 Nivel mesatar
10	Prishtinë	11	3	12.5 / 25	50%	🟡 Nivel mesatar
11	Pejë	4	16	12.0 / 25	48%	🟡 Nivel mesatar
12	Dragash	7	8	11.0 / 25	44%	🟡 Nivel mesatar
13	Obiliq	6	9	10.5 / 25	42%	🟡 Nivel mesatar
14	Mitrovicë e Jugut	6	7	9.5 / 25	38%	🟠 Nivel i ulët
15	Klinë	5	4	7.0 / 25	28%	🟠 Nivel i ulët
16	Ferizaj	1	12	7.0 / 25	28%	🟠 Nivel i ulët

17	Gllogoc	0	14	7.0 / 25	28%	🟠 Nivel i ulët
18	Fushë Kosovë	0	13	6.5 / 25	26%	🟠 Nivel i ulët
19	Kamenicë	0	13	6.5 / 25	26%	🟠 Nivel i ulët
20	Skënderaj	0	13	6.5 / 25	26%	🟠 Nivel i ulët
21	Gjakovë	6	0	6.0 / 25	24%	🟠 Nivel i ulët
22	Mamushë	3	4	5.0 / 25	20%	🟠 Nivel i ulët
23	Gjilan	4	0	4.0 / 25	16%	🔴 Nivel shumë i ulët
24	Viti	1	6	4.0 / 25	16%	🔴 Nivel shumë i ulët
25	Vushtrri	3	0	3.0 / 25	12%	🔴 Nivel shumë i ulët
26	Podujevë	1	4	3.0 / 25	12%	🔴 Nivel shumë i ulët
27	Mitrovicë e Veriut	0	6	3.0 / 25	12%	🔴 Nivel shumë i ulët
28	Ranillug	0	0	0.0 / 25	0%	🔴 Nivel shumë i ulët

KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

Konkluzionet

- Rezultatet e monitorimit tregojnë se komunat kanë bërë hapa të rëndësishëm në krijimin e mekanizmave institucionalë dhe në formalizimin e disa përgjegjësive në fushën e shërbimeve sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve. Megjithatë, ky progres nuk është i njëtrajtshëm dhe nuk reflektohet në të njëjtën masë në ofrimin konkret të shërbimeve, në financimin e tyre, në kontraktimin e ofruesve të jashtëm dhe në monitorimin e cilësisë.

- Në përgjithësi, analiza e gjashtë dimensioneve tregon një dallim të qartë ndërmjet asaj që mund të konsiderohet si kapacitet formal institucional dhe asaj që përbën kapacitet real zbatues. Strukturat, mekanizmat dhe proceset planifikuese paraqiten relativisht më të zhvilluara, ndërsa boshllëqet bëhen më të dukshme në momentin kur kërkohet që këto struktura të prodhojnë shërbime konkrete, të mbështetura me financim dhe të dokumentuara përmes rezultateve të matshme.

- Kjo shihet qartë edhe në krahasimin ndërmjet dimensioneve. Fusha me nivelin më të lartë të përmbushjes është Ofrimi i shërbimeve sociale, me 61.9%, e ndjekur shumë afër nga Mekanizmat institucionalë, me 60.7%. Në anën tjetër, rezultatet më të ulëta janë evidentuar në Shërbimet specifike për fëmijë, me vetëm 29.5%, dhe në Financim, me 38.6%.

- Ky dallim tregon se komunat janë relativisht më të avancuara në krijimin e strukturave bazë dhe në ofrimin e formave të përgjithshme të informacionit dhe shërbimeve sociale, ndërsa mbeten më të kufizuara kur bëhet fjalë për forma të specializuara të kujdesit dhe për sigurimin e financimit të qëndrueshëm për to.

- Një nga gjetjet kryesore lidhet me funksionalizimin e mekanizmave institucionalë. Themelimi i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës paraqet një nga rezultatet më të larta të monitorimit, me 82.1% përmbushje. Megjithatë, funksionimi praktik i tij është dukshëm më i ulët, pasi mbajtja e takimeve të Ekipit është evidentuar vetëm në 53.6% të komunave. Ky dallim tregon se krijimi formal i strukturave nuk garanton domosdoshmërisht funksionimin e rregullt të tyre.

- Dobësi është evidentuar edhe në kapacitetet profesionale të specializuara. Vetëm 42.9% e komunave rezultojnë me zyrtar të specializuar për mbrojtjen e fëmijës në QPS. Kjo tregon se forcimi i mekanizmave duhet të shoqërohet me investim në burime njerëzore dhe profesionalizim të rolit të aktorëve përgjegjës.

- Në fushën e planifikimit, rezultati më pozitiv lidhet me konsultimin me OJQ dhe aktorë lokalë, me 71.4% përmbushje. Megjithatë, planifikimi social i bazuar në analiza të nevojave dhe programet konkrete për mirëqenien e fëmijëve rezultojnë vetëm me 50% përmbushje. Kjo tregon se konsultimi është relativisht më i zhvilluar sesa përkthimi i nevojave të identifikuara në plane dhe programe të strukturuara.

- Kjo është një gjetje me rëndësi, sepse planifikimi duhet të jetë hallka që lidh analizën e nevojave me financimin dhe ofrimin e shërbimeve. Kur kjo lidhje është e dobët, ekziston rreziku që dokumentet planifikuese të mbeten formale dhe të mos ndikojnë mjaftueshëm në vendimmarrjen praktike.

- Në fushën e ofrimit të shërbimeve sociale, rezultatet janë relativisht më të mira, por përsëri paraqiten boshllëqe. Informimi i qytetarëve përmes QPS-së arrin 67.9% përmbushje, ndërsa lista publike e shërbimeve sociale vetëm 57.1%. Kjo tregon se ekziston një bazë funksionale për informimin e qytetarëve, por transparenca dhe qasja e strukturuar në informacion duhet të përmirësohen.

- Dobësia më e madhe e sistemit paraqitet te shërbimet specifike për fëmijë. Me vetëm 29.5% përmbushje të përgjithshme, ky dimension evidenton mungesën më të madhe ndërmjet mekanizmave formalë dhe ofrimit real të shërbimeve. Qendrat e kujdesit ditor kanë vetëm 17.9% përmbushje, ndërsa shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve dhe shtëpitë me bazë në komunitet nga 21.4%.

- Kjo tregon se format më të specializuara të kujdesit, të cilat kërkojnë staf profesional, infrastrukturë dhe financim të vazhdueshëm, janë shumë më pak të zhvilluara në nivel lokal. Në këtë aspekt, shërbimet në shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe sëmundje të rënda kronike, me 57.1% përmbushje, paraqesin rezultat dukshëm më të mirë, por ende jo të mjaftueshëm për të krijuar një mbulim të barabartë.

- Dimensioni i financimit e konfirmon këtë problem. Përmbushja e përgjithshme është vetëm 38.6%. Ndërsa mbështetja financiare për familjet strehuese arrin 60.7%, financimi i qendrave të kujdesit ditor dhe i shtëpive me bazë në komunitet është vetëm 21.4%.

- Kjo krijon një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet mungesës së shërbimit dhe mungesës së financimit. Shërbimet që ofrohen më pak janë njëkohësisht edhe ato që financohen më pak. Për këtë arsye, zhvillimi i shërbimeve nuk mund të trajtohet i ndarë nga planifikimi buxhetor.

- Në fushën e kontraktimit dhe licencimit, licencimi paraqet rezultat relativisht të mirë, me 75% përmbushje. Megjithatë, kontraktimi i shërbimeve, përputhshmëria e kontratave me planin vjetor dhe monitorimi i cilësisë kanë secili vetëm 42.9% përmbushje.

- Veçanërisht e rëndësishme është gjetja se për monitorimin e cilësisë nuk është evidentuar asnjë rast me evidencë primare. Kjo tregon se edhe aty ku komunat deklarojnë se monitorojnë ofruesit, procesi nuk dokumentohet në mënyrë të mjaftueshme.

- Një tjetër gjetje e rëndësishme dhe horizontale është dallimi ndërmjet të dhënave primare dhe sekondare. Në shumë raste, komunat kanë deklaruar se një përgjegjësi është përmbushur, por pa ofruar dokumentacion të mjaftueshëm për ta dëshmuar atë. Kjo tregon se përmirësimi i performancës duhet të shoqërohet edhe me përmirësimin e dokumentimit, arkivimit dhe publikimit të evidencës institucionale.

- Në këtë kuptim, raporti tregon se përmbushja nuk duhet të kuptohet vetëm si realizim i një aktiviteti ose ekzistencë e një mekanizmi. Përmbushja e qëndrueshme kërkon që veprimi të jetë i planifikuar, i financuar, i realizuar, i monitoruar dhe i dokumentuar.

- Krahasimi me Raportin Vjetor 2025 për zbatimin e politikave komunale në fushën e të drejtave të fëmijëve përforcon këtë përfundim. Edhe ai raport evidenton se strukturat dhe planet ekzistojnë në një numër relativisht të madh komunash, por funksionalizimi, zbatimi i aktiviteteve dhe financimi mbeten më të kufizuara.

- Në tërësi, mund të konkludohet se sistemi komunal ndodhet në një fazë ku formalizimi institucional është më i avancuar sesa zbatimi funksional. Sfida kryesore për periudhën e ardhshme është që mekanizmat ekzistues të shndërrohen në kapacitete reale për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme.

Rekomandimet

- Në bazë të gjetjeve të monitorimit, prioriteti kryesor duhet të jetë funksionalizimi i plotë i mekanizmave ekzistues. Komunat duhet të sigurojnë që Ekipet për të Drejtat e Fëmijës të kenë takime të rregullta, plane pune, përgjegjësi të qarta dhe dokumentim të aktiviteteve. Në të njëjtën kohë, duhet të plotësohen boshllëqet në kapacitetet profesionale, sidomos përmes sigurimit të zyrtarëve të specializuar për mbrojtjen e fëmijëve në QPS.

- Planifikimi social duhet të lidhet më drejtpërdrejt me analizën e nevojave. Komunat duhet të zhvillojnë periodikisht analiza të strukturuara që identifikojnë grupet në nevojë, shërbimet që mungojnë dhe kapacitetet ekzistuese. Këto analiza duhet të shërbejnë si bazë për planifikimin programor dhe buxhetor, në mënyrë që planet të mos mbeten vetëm dokumente formale.

- Një prioritet i veçantë duhet t'i jepet zhvillimit të shërbimeve specifike për fëmijë. Duke qenë se ky dimension ka nivelin më të ulët të përmbushjes, komunat duhet të vlerësojnë në mënyrë sistematike nevojën për qendra ditore, shërbime në shtëpi, shërbime rezidenciale dhe forma të kujdesit me bazë në komunitet.

- Në rastet kur kapacitetet individuale të komunës nuk janë të mjaftueshme, duhet të shqyrtohet më seriozisht bashkëpunimi ndërkomunal dhe kontraktimi i ofruesve të licencuar. Jo çdo komunë duhet domosdoshmërisht të krijojë të gjitha shërbimet vetë, por duhet të sigurojë qasje reale për qytetarët në shërbimin e nevojshëm.

- Financimi duhet të trajtohet si element qendror i zhvillimit të sistemit. Komunat duhet të krijojnë ndarje më të qarta dhe të identifikueshme buxhetore për shërbimet sociale dhe për shërbimet specifike për fëmijë. Planifikimi financiar duhet të lidhet me prioritetet e identifikuara në planet sociale dhe me shërbimet që aktualisht mungojnë.

- Po ashtu, rekomandohet që financimi të mos kufizohet vetëm në mbulimin e kostove ekzistuese, por të përdoret edhe për zhvillimin gradual të shërbimeve të reja. Në këtë aspekt, qendrat e kujdesit ditor dhe shërbimet me bazë në komunitet duhet të konsiderohen si fusha prioritare.

- Kontraktimi me OJQ dhe ofrues të tjerë të licencuar duhet të përdoret në mënyrë më strategjike. Kontratat duhet të jenë të lidhura me planet vjetore dhe analizat e nevojave, ndërsa çdo kontratë duhet të përmbajë objektiva të qarta, rezultate të pritshme dhe indikatorë të performancës.

- Një nga rekomandimet më të rëndësishme lidhet me monitorimin e cilësisë. Duke qenë se nuk është identifikuar evidencë primare për këtë indikator, komunat duhet të zhvillojnë procedura të standardizuara të monitorimit të ofruesve. Këto procedura duhet të përfshijnë vizita monitoruese, raporte periodike, indikatorë të cilësisë dhe mekanizma për trajtimin e mangësive.

- Gjithashtu, duhet të përmirësohet dukshëm dokumentimi institucional. Çdo aktivitet, takim, plan, kontratë apo shërbim i realizuar duhet të shoqërohet me dokumentacion të qartë dhe të ruhet në mënyrë të strukturuar.

- Komunat duhet të përmirësojnë edhe transparencën ndaj qytetarëve. Informacioni për shërbimet sociale, kriteret e përfitimit, kontaktet, ofruesit dhe programet për fëmijë duhet të jetë i publikuar dhe lehtësisht i qasshëm në ueb-faqet komunale.

- Në nivel më të gjerë, rekomandohet që raportimi komunal në këtë fushë të standardizohet. Një format i unifikuar i raportimit do të ndihmonte në krahasimin e të dhënave ndërmjet komunave dhe do të përmirësonte cilësinë e evidencës.

- Në të njëjtën kohë, komunat që paraqesin performancë më të mirë dhe nivel të lartë të evidencës primare mund të përdoren si shembuj për shkëmbimin e praktikave dhe për zhvillimin e modeleve që mund të përshtaten edhe në komunat e tjera.

- Së fundi, rezultatet e monitorimit duhet të përdoren për mbështetje të diferencuar të komunave. Komunat që kanë boshllëqe në mekanizma institucionalë kanë nevojë për mbështetje në forcimin e strukturave, ndërsa ato që kanë mekanizma por mungesë shërbimesh duhet të fokusohen më shumë në financim, kontraktim dhe zhvillim të ofrimit së shërbimeve.

KOSOVO LOCAL GOVERNMENT INSTITUTE

Adresa: Rr. "Ukshin Hoti", Prime Group Residence 2, Hyrja A, Kati 19, Prishtinë, Kosovë, 10000 |
Tel: +383 38 522 000 | Email: info@klgi-ks.com